

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe e Formimit Profesional

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

SHËRBIME MJETESH
TRANSPORTI

Niveli I

Kodi: M-I-15

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2015

Përmbajtja

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti” niveli I.
2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “ Shërbime mjetesh transporti, niveli I.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “ **Shërbime mjetesh transporti**”, niveli I, është “*zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me shërbimin e mjeteve të transportit*”. Zhvillimi te nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale, këto janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës në fushën e shërbimit të mjeteve të transportit që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “**Shërbime mjetesh transporti**” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MASH përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “ Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “ **Shërbime mjetesh transporti**”, niveli I, nxënësit do të kenë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tyre dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënësve të tyre dhe të shfaqin gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojnë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “ Shërbime mjetesh transporti”, niveli I

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti” niveli I, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të respektojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për shërbime mjetesh transporti.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për shërbime mjetesh transporti.
- Të kryejë matje dhe kontrole të nevojshme për shërbime mjetesh transporti.
- Të kryejë punime të ndryshme axhusterike, të nevojshme për shërbime mjetesh transporti.
- Të kryejë punime të ndryshme saldimi, të nevojshme për shërbime mjetesh transporti
- Të kryejë zmontime, pastrime dhe montime të pjesëve dhe agregateve të mjeteve të transportit.
- Të kryejë zmontime, pastrime dhe montime të pjesëve të motorëve të mjeteve të transportit.
- Të kryejë punime të zakonshme në sistemin e vajisjes së motorit.
- Të kryejë punime të zakonshme në sistemin e ftohjes së motorit.
- Të kryejë punime të zakonshme në sistemet e ushqimit të motorëve “Otto” dhe “Diesel”.
- Të kryejë rregullime e përshtatje në mekanizmat e shpërndarjes së gazeve të motorëve.
- Të kryejë zmontime, pastrime dhe montime të elementeve të transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit.
- Të kryejë punime të zëvendësimit, mirëmbajtjes e riparimit në sistemet e drejtimit dhe të frenimit të automjeteve të lehta.
- Të kryejë punime të zëvendësimit, mirëmbajtjes e riparimit në elementet e sistemit të varjes së mjeteve të transportit.

- Të kryejë punime të riparimit, zëvendësimit dhe ballancimit të rrotave të automjeteve të lehta.
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në burimet e energjisë elektrike të mjeteve të transportit.
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në pajisjet elektrike dhe elektronike të mjeteve të transportit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “ Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “ Shërbime mjetesh transporti”, niveli I, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim profesional, me të drejtë vazhdimin e arsimimit në nivelin II të arsimit profesional në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi.

Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje/servise të ndryshme që kryejnë shërbime të mirëmbajtjes, riparimit dhe kolaudimit të mjeteve të transportit. Gjithashtu, me studime dhe përvojë pune të mëtjshme, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose të krijojë biznesin e tij në fushën e shërbimeve të zakonshme të mjeteve të transportit. Me vijimin e mëtjshëm të arsimit profesional në Nivelin II, nxënësi certifikohet si punonjës i kualifikuar dhe më pas, mund të vijojë studimet në Nivelin III për të fituar “maturën profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I

Plani mësimor për drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, Nivelin I				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Niveli I	
			Orët javore (vjetore)	
			Klasa 10	Klasa 11
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/17 (540/ 612)	11/13 (374/ 442)
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1
2		Gjuhë e huaj	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-
5		Histori	1	1
6		Matematikë	2	1
7		Fizikë	2	1
8		Kimi	1	2
9		Teknologji informimi e komunikimi	1	1
10		Edukim fizik	2	1
11		Edukim për karrierën	-	1

B.		Lëndët profesionale	(Gjithsej)	10(360)	8 (272)
1	L-01-072-15	Vizatim teknik		3	-
2	L-04-073-09	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit		2	1
3	L-18-074-15	Njohuri për mjetet e transportit		3	3
4	L-18-075-15	Shërbime mjetesh transporti		2	2
5	L-11-076-15	Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit		-	2
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale	(Gjithsej)	5 (180)	10 (340)
1	M-04-210-11	Punime axhusterie		36	-
2	M-04-211-09	Punime saldimi		36	-
3	M-18-212-11	Punime zmontimi dhe montimi në automjete		36	-
4	M-18-721-11	Punime në friksionet dhe kutitë e shpejtësisë së automjeteve		36	-
5	M-18-215-11	Punime në rrotat e automjeteve		36	-
6	M-18-216-15	Punime kryesore në sistemet e motorëve të automjeteve		-	85
7	M-18-217-11	Punime kryesore në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve të motorëve të automjeteve		-	36
8	M-18-1182-15	Punime kryesore në sistemin elektrik dhe elektronik të automjeteve		-	51
9	M-18-219-09	Punime kryesore në transmisionin e automjeteve		-	36
10	M-18-1183-15	Punime në hidrotransformator dhe kutinë e shpejtësisë automatike			33
11	M-18-220-11	Punime në sistemin e drejtimit të automjeteve		-	33
12	M-18-221-11	Punime në sistemin e frenimit të automjeteve		-	33
13	M-18-222-11	Punime në elementet e sistemit të varjes së automjeteve		-	33
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar	(Gjithsej)	1 (36)	2 (68)
1	M-18-225-15	Punime në sistemin e ushqimit të motorëve		36	-
2	M-18-224-09	Punime në sistemet ndihmëse të automjeteve.		36	-
3	M-18-1184-15	Punime në sistemin e ajrit të kondicionuar të automjeteve		-	68
4	M-18-226-09	Punime zëvendësimi në karrocërinë e automjeteve		-	68
		Gjithsej A+B+C+D		31/33 (1116/ 1188)	31/33 (1054/ 1122)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 11 viti shkollor ka gjithësej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 1 javë për provimin e teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë 33 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).

- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “**Shërbime mjetesh transporti**”, **niveli I**.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Shërbime mjetesh transporti”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me **nota** (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e shërbimit të automjeteve, dhe u jepen certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli I

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesesh transporti” niveli I shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MASH, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Vizatim teknik” (L-01-072-15) - Kl. 10 - 108 orë

- Synimet e lëndës “Vizatim teknik”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatim teknik.”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë dhe qëllimet e vizatimit teknik.
- Të lexojnë dhe të kryejnë skica të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.
- Të përdorin materialet, veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik për të kryer ndërtime gjeometrike dhe vizatime të thjeshta.
- Të kryejnë skica dhe vizatime të thjeshta detalesh duke përdorur standardet për paraqitjet, për vendosjen e përmasave dhe ato për paraqitjeve me prerje.
- Të ndërtojnë paraqitje aksonometrike të figurave, të trupave gjeometrikë, modeleve mësimore dhe detaleve të thjeshtë.
- Të lexojnë paraqitjen dhe shënimin e filetave në vizatim dhe të paraqesin e shënojnë pjesët e filetuara në detale të thjeshta.
- Të bëjnë skica dhe të lexojnë vizatime të bashkimeve të thjeshta me fileto.
- Të lexojnë vizatime të bashkimeve të thjeshta me kiaveta, kunja, perçina dhe saldim.
- Të lexojnë vizatime të thjeshta të rrotave të dhëmbëzuara dhe të transmesioneve të tyre.
- Të lexojnë vizatimet e sustave.
- Të lexojnë dhe kryejnë vizatime të thjeshta që përmbajnë pamje të pjesshme, pamje ndihmëse, elemente të nxjerra dhe marrëveshje për paraqitjet.
- Të kryejnë skica dhe vizatime pune të thjeshta dhe të lexojnë vizatime pune të vështirësisë mesatare.
- Të lexojnë dhe të detalizojnë vizatime përmbledhëse të thjeshta.
- Të lexojnë dhe interpretojnë vizatimet skematike të llojeve të ndryshme.
- Të lexojnë dhe interpretojnë skemat kinematike që paraqesin ndërtimin dhe funksionimin e automjeteve.
- Të lexojnë dhe interpretojnë skemat hidraulike të automjeteve.
- Të lexojnë dhe interpretojnë skemat pneumatike të automjeteve
- Të lexojnë dhe interpretojnë skemat elektrike dhe elektronike të automjeteve.
- Të lexojnë dhe interpretojnë skemat të ndryshme të paraqitura në aksonometri.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatim teknik”, kl 10 - 108 orë

Tema 1	Njohuri për vizatimet teknike	2 orë
Tema 2	Skicimi (paraqitjet me dorë të lirë)	2 orë
Tema 3	Materialet, veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik, përdorimi i tyre	2 orë
Tema 4	Ndërtimet gjeometrike kryesore	4 orë
Tema 5	Shkrimi teknik	2 orë
Tema 6	Paraqitjet me disa pamje	8 orë
Tema 7	Njohuri për vendosjen e përmasave	6 orë
Tema 8	Skicat dhe vizatimet e detaleve	8 orë
Tema 9	Paraqitjet me prerje. Prerjet e thjeshta	8 orë
Tema 10	Prerjet e përbëra	2 orë
Tema 11	Paraqitjet aksonometrike	8 orë

Tema 12	Paraqitja dhe shënimi i filetave në vizatim.	4 orë
Tema 13	Paraqitja e bashkimeve me fileto	4 orë
Tema 14	Paraqitja e bashkimeve me kiaveta, me kunjja dhe me perçina.	4 orë
Tema 15	Paraqitja dhe shënimi i bashkimeve me saldim.	2 orë
Tema 16	Paraqitja e rrotave të dhëmbëzuara dhe transmesioneve me rrota të dhëmbëzuara	4 orë
Tema 17	Paraqitja e sustave në vizatim	2 orë
Tema 18	Pamjet bazë, pamjet e pjesëshme, pamjet ndihmëse, elementët e nxjerrë dhe marrëveshjet për paraqitjet.	6 orë
Tema 19	Vizatimet e punës së detaleve, përmasat në vizatimet e punës. Përmbajtja e vizatimeve të punës së detaleve, leximi i vizatimeve të punës së detaleve	6 orë
Tema 20	Vizatimet përmbledhëse, leximi dhe detalizimi i vizatimeve përmbledhëse	6 orë
Tema 21	Njohuri për vizatimet skematike	2 orë
Tema 22	Skemat kinematike, leximi i tyre	3 orë
Tema 23	Skemat hidraulike, leximi i tyre	3 orë
Tema 24	Skemat pneumatike, leximi i tyre	2 orë
Tema 25	Skemat elektrike, leximi i tyre	3 orë
Tema 26	Skemat elektronike, leximi i tyre	3 orë
Tema 27	Paraqitja aksonometrike e skemave	2 orë

2. Lënda “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit” (L-04-073-09) - Kl. 10 - 72 orë dhe Kl. 11 – 34 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të bëjnë klasifikimin e materialeve të makinave.
- Të tregojnë përdorimet e materialeve të makinave.
- Të përshkruajnë vetitë fizike, kimike, mekanike dhe teknologjike të materialeve.
- Të tregojnë përkufizojnë makinat dhe detalet e makinave.
- Të përshkruajnë parimin e punës së makinave të thjeshta.
- Të përshkruajnë detalet, lidhjet, mekanizmat dhe transmisionet tipike që përdoren në makinat dhe mjetet e transportit.
- Të japin kuptimin e forcave dhe momenteve të forcave.
- Të bëjnë mbledhjen dhe zbërthimin e forcave dhe momenteve të forcave.
- Të përshkruajnë veoritë e statikës, kinematikës dhe dinamikës së trupave.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta që lidhen me statikën, kinematikën dhe dinamikën e trupave të ngurtë.
- Të shpjegojnë kuptimin e koncepteve “ngarkesë” dhe “sforcim” i materialeve.
- Të analizojnë llojet e ndryshme të ngarkesave dhe sforcimeve.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta që kanë të bëjnë me ngarkesat dhe sforcimet e materialeve

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”, kl. 10 - 72 orë:**

Tema 1	Hyrje në materialet e makinave.	2 orë
Tema 2	Vetitë fizike, kimike, mekanike dhe teknologjike të materialeve	4 orë
Tema 3	Materialet metalike	4 orë
Tema 4	Lidhjet e metaleve	2 orë
Tema 5	Materialet jo metalike	2 orë
Tema 6	Hyrje në makinat dhe detalet e makinave	2 orë
Tema 7	Makinat e thjeshta	3 orë
Tema 8	Detalet tipike të makinave	3 orë
Tema 9	Lidhjet e detaleve (nyjet tipike)	3 orë
Tema 10	Mekanizmat tipike të makinave	4 orë
Tema 11	Transmisionet (sistemet) tipike të makinave	6 orë
Tema 12	Hyrje në mekanikën teorike	2 orë
Tema 13	Forcat dhe momentet, shuma dhe zbërthimi i tyre	4 orë
Tema 14	Statika e trupave	3 orë
Tema 15	Kinematika e trupave	4 orë
Tema 16	Dinamika e trupave	4 orë
Tema 17	Llogaritje të thjeshta për statikën, kinematikën dhe dinamikën	4 orë
Tema 18	Hyrje në rezistencën e materialeve	2 orë
Tema 19	Kuptimi për ngarkesat dhe sforcimet e materialeve	3 orë
Tema 20	Shtypja, tërheqja, përkulja, përdredhja dhe prerja	6 orë
Tema 21	Ngarkesat e kombinuara	2 orë
Tema 22	Llogaritje të thjeshta për ngarkesat dhe sforcimet e materialeve	3 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”, klasa 11, nxënësit duhet:

- Të japin kuptimin e përpunimit të detaleve.
- Të klasifikojnë metodat kryesore të përpunimit të detaleve.
- Të përshkruajnë veçoritë dhe përdorimet e metodave kryesore të përpunimit të detaleve.
- Të japin kuptimin e tolerancave teknike.
- Të përshkruajnë tolerancat e përmasave dhe tregojnë si shënohen ato.
- Të japin kuptimin e tolerancave të vendosjeve.
- Të përshkruajnë llojet e vendosjeve.
- Të përshkruajnë veçoritë e sistemit ISO të tolerancave dhe vendosjeve.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”, kl. 11 - 34 orë:**

Tema 1	Hyrje në përpunimin e detaleve	2 orë
Tema 2	Përpunimi me derdhje	2 orë
Tema 3	Përpunimi me deformim plastik	2 orë
Tema 4	Përpunimi me prerje	2 orë
Tema 5	Përpunimi me saldim dhe ngjitje	3 orë
Tema 6	Përpunimi me heqje ashkle	4 orë
Tema 7	Përpunimi kimiko-termik	2 orë
Tema 8	Përpunimi axhusterik	2 orë
Tema 9	Metoda të tjera të përpunimit të detaleve.	2 orë

Tema 10	Hyrje në tolerancat teknike	2 orë
Tema 11	Saktësia e punimit. Kuptimi dhe llojet e tolerancave të përmasave.	3 orë
Tema 12	Çiftëzimet e detaleve dhe llojet e vendosjeve	3 orë
Tema 13	Standardi i tolerancave ISO	3 orë
Tema 14	Saktësia dhe ashpërsia e sipërfaqeve të detaleve	2 orë

3. Lënda “Njohuri për mjetet e transportit” (L-18-074-15) - Kl. 10 - 108 orë dhe Kl. 11 - 102 orë

- **Synimet e lëndës “Njohuri për mjetet e transportit”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për mjetet e transportit” klasa 10, nxënësit duhet:

- të tregojnë kuptimin për “transportin”, “sistemet e transportit” dhe “mjetet e transportit” dhe të tregojnë ndikimet e tyre në shoqëri dhe në mjedis;
- të bëjnë klasifikimin e sistemeve të transportit, mjeteve të transportit dhe sistemeve të mjeteve të transportit;
- të tregojnë parimin e punës, pjesët kryesore, llojet dhe përdorimet e motorëve me djegie të brendshme (MDB);
- të përshkruajnë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmave dhe sistemeve të MDB të tipeve “Otto” dhe “Diesel”;
- të përshkruajnë lëndët djegëse të MDB dhe karakteristikat e tyre;
- të përshkruajnë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e burimeve të energjisë elektrike në mjetet e transportit;
- të tregojnë kuptimin e parametrave teknike të MDB dhe faktorët që ndikojnë në to;
- të bëjnë krahasimin e tipeve të ndryshme të MDB.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për mjetet e transportit”, kl. 10 - 108 orë:**

Tema 1	Hyrje në transport	3 orë
Tema 2	Sistemet e transportit dhe klasifikimi i tyre	4 orë
Tema 3	Mjetet e transportit dhe klasifikimi i tyre	4 orë
Tema 4	Sistemet kryesore të mjeteve të transportit	6 orë
Tema 5	Njohuri të përgjithshme për motorët me djegie të brendshme (MDB)	3 orë
Tema 6	Ndërtimi i përgjithshëm i MDB të tipeve “Otto” dhe “Diesel”.	10 orë
Tema 7	Sistemi i ndezjes së MDB	10 orë
Tema 8	Sistemi i ftohjes së MDB	8 orë
Tema 9	Sistemi i vajisjes së MDB	8 orë
Tema 10	Njohuri për lëndët djegëse në mjetet e transportit	4 orë
Tema 11	Sistemi i ushqimit me karburator	6 orë
Tema 12	Sistemi i ushqimit me injeksion të benzinës	8 orë
Tema 13	Sistemi i ushqimit me injeksion të naftës	8 orë
Tema 14	Sistemet e shkarkimit të produkteve të djegies	6 orë
Tema 15	Burimet e energjisë elektrike në mjete transporti	10 orë
Tema 16	Sistemi i lëshimit të motorit	6 orë
Tema 17	Parametrat teknike të MDB	4 orë

- **Synimet e lëndës “Njohuri për mjetet e transportit”, kl. 11 – 102 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për mjetet e transportit” klasa 11, nxënësit duhet:

- të rendisin agregatet kryesore të transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit;
- të përshkruajnë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e agregateve kryesore të transmetimit të fuqisë;
- të përshkruajnë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e urave dhe rrotave të automjeteve;
- të përshkruajnë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve varëse, strukturore, të drejtimit dhe të frenimit në mjetet e transportit;
- të përshkruajnë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve ndihmëse, të ndriçimit dhe sinjalizimit në mjetet e transportit;
- të përshkruajnë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit;
- të tregojnë kuptimin e parametrave teknike të mjeteve të transportit dhe faktorët që ndikojnë në to;
- të bëjnë krahasimin e mjeteve të ndryshme të transportit;
- të tregojnë prirjet e zhvillimit të sistemeve dhe mjeteve të transportit në të ardhmen.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për mjetet e transportit”, kl. 11 - 102 orë:**

Tema 1	Freksionet e mjeteve të transportit	7 orë
Tema 2	Kutitë e shpejtësive në mjetet e transportit	10 orë
Tema 3	Transmisionet kardanike në mjetet e transportit	6 orë
Tema 4	Urat e automjeteve	9 orë
Tema 5	Rrotat e automjeteve	7 orë
Tema 6	Sistemet varëse (të suspensionit) në mjetet e transportit	10 orë
Tema 7	Sistemet e drejtimit të mjeteve të transportit	8 orë
Tema 8	Sistemet e frenimit të mjeteve të transportit	9 orë
Tema 9	Sistemet strukturore (shasitë-kabinat) në mjetet e transportit	6 orë
Tema 10	Sistemet e ndriçim-sinjalizimit në mjetet e transportit	9 orë
Tema 11	Sistemet elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit	5 orë
Tema 12	Sistemet ndihmëse në mjetet e transportit	9 orë
Tema 13	Parametrat teknike të mjeteve të transportit	3 orë
Tema 14	Prirjet e zhvillimit të sistemeve dhe mjeteve të transportit	4 orë

4. Lënda “Shërbime mjetesh transporti” (L-18-075-15) - Kl. 10 - 72 orë dhe Kl. 11 - 68 orë

- **Synimet e lëndës “Shërbime mjetesh transporti”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shërbime mjetesh transporti”, klasa 10, nxënësit duhet:

- të tregojnë kuptimin për “transportin”, “sistemet e transportit” dhe “mjetet e transportit”;
- të tregojnë veçoritë e profesioneve që veprojnë në shërbimet e mjeteve të transportit;
- të bëjnë klasifikimin e mjeteve të transportit dhe të shërbimeve të tyre;
- të përshkruajnë ndërtimin, funksionimin dhe pajisjen e një servisi automjetesh;
- të analizojnë aspekte të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mjeteve të transportit;

- të përshkruajë dëmtimet kryesore të detaleve dhe nyjeve në makina dhe shkaqet e tyre;
- të tregojë masat për parandalimin dhe pakësimin e dëmtimeve në makina;
- të renditë metodat e riparimit të detaleve të makinave;
- të përshkruajë veprimet për mirëmbajtjen e motorëve të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në sistemet dhe mekanizmat e motorëve të automjeteve;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shërbime mjeteve transporti”, kl 10 - 72 orë:**

Tema 1	Hyrje në shërbimet e mjeteve të transportit	3 orë
Tema 2	Klasifikimi i shërbimeve të mjeteve të transportit	4 orë
Tema 3	Ndërtimi dhe funksionimi i një servisi automjeteve	4 orë
Tema 4	Veglat dhe pajisjet e punës në një servis automjeteve	6 orë
Tema 5	Siguria dhe mbrojtja e mjedisit në shërbimet e mjeteve të transportit.	3 orë
Tema 6	Përdorimi i informacionit teknik në shërbimet e mjeteve të transportit	3 orë
Tema 7	Llojet dhe përshkrimi i dëmtimeve të detaleve dhe nyjeve në makina	6 orë
Tema 8	Konsumimi dhe vajtja e detaleve dhe nyjeve të makinave	5 orë
Tema 9	Metodat e riparimit të detaleve të makinave	6 orë
Tema 10	Shërbimet e mirëmbajtjes në motorët e mjeteve të transportit	5 orë
Tema 11	Punime të zëvendësimit në sistemin e vajtjes së motorit	5 orë
Tema 12	Punime të zëvendësimit në sistemin e ftohjes së motorit	4 orë
Tema 13	Punime të zëvendësimit në sistemin e ushqimit të motorit	6 orë
Tema 14	Punime të zëvendësimit në burimet e energjisë elektrike	4 orë
Tema 15	Punime të zëvendësimit në sistemin e ndezjes së motorit	4 orë
Tema 16	Punime të zëvendësimit në sistemin e lëshimit të motorit	4 orë

• **Synimet e lëndës “Shërbime mjeteve transporti”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shërbime mjeteve transporti”, klasa 11, nxënësit duhet:

- të përshkruajë veprimet për mirëmbajtjen e transmisioneve të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në agregatet e transmisioneve të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë veprimet për mirëmbajtjen e rrotave dhe varëseve të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në rrotat dhe varëset e mjeteve të transportit;
- të përshkruajë veprimet për mirëmbajtjen e sistemeve strukturore, të drejtimit, të frenimit, të ndriçim-sinjalizimit dhe sistemet ndihmëse të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në sistemet strukturore, të drejtimit, të frenimit, të ndriçim-sinjalizimit dhe sistemet ndihmëse të mjeteve të transportit;
- të përshkruajë punimet të zëvendësimit të pjesëve në sistemet elektronike dhe kompjuterike të automjeteve

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shërbime mjeteve transporti”, kl. 11 – 68 orë:**

Tema 1	Shërbimet e mirëmbajtjes në transmisionet e mjeteve të transportit	4 orë
Tema 2	Punime të zëvendësimit në freksionet e automjeteve	5 orë
Tema 3	Punime të zëvendësimit në kutinë e shpejtësisë së automjeteve	6 orë

Tema 4	Punime të zëvendësimit në transmisionet kardanike të automjeteve	3 orë
Tema 5	Punime të zëvendësimit në urat e automjeteve	5 orë
Tema 6	Shërbimet e mirëmbajtjes në rrota dhe sistemet varëse të automjeteve	3 orë
Tema 7	Punime të zëvendësimit në rrotat e automjeteve	4 orë
Tema 8	Punime të zëvendësimit në sistemet varëse të automjeteve	5 orë
Tema 9	Shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet e drejtimit dhe frenimit të automjeteve	3 orë
Tema 10	Punime të zëvendësimit në sistemet e drejtimit të automjeteve	5 orë
Tema 11	Punime të zëvendësimit në sistemet e frenimit të automjeteve	6 orë
Tema 12	Shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet strukturore, ndriçim-sinjalizimit dhe ndihmëse të automjeteve.	4 orë
Tema 13	Punime të zëvendësimit në sistemet strukturore të automjeteve	3 orë
Tema 14	Punime të zëvendësimit në sistemet e ndriçim-sinjalizimit të automjeteve	4 orë
Tema 15	Punime të zëvendësimit në sistemet elektronike dhe kompjuterike të automjeteve.	3 orë
Tema 16	Punime të zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve	5 orë

5. Lënda “Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit” (L-11-076-15) - Kl. 11 - 68 orë

- **Synimet e lëndës “Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit” në kl. 11 nxënësit duhet:

- të përshkruajnë objektin e elektroteknikës dhe rëndësinë e saj për mjetet e transportit;
- të tregojnë kuptimin e madhësive elektrike dhe simbolikën e tyre;
- të bëjnë dallimin midis përcjellësve dhe izolatorëve të rrymës elektrike;
- të përshkruajnë efektet kryesore të rrymës elektrike;
- të tregojnë rreziqet nga rryma elektrike dhe masat për mbrojtjen prej saj;
- të dallojnë elementet e ndryshëm të skemave elektrike tipike;
- të përshkruajnë veçoritë e skemave elektrike tipike;
- të zbatojnë ligjin e Ohmit në një pjesë të qarkut si dhe në qarqe elektrike të thjeshta;
- të shpjegojnë dukuritë e elektromagnetizimit dhe induksionit elektromagnetik;
- të përshkruajnë veçoritë dhe përdorimet në mjetet e transportit të elementeve kryesore të skemave elektrike (çelësave, rezistencave, bobinave, kondensatorëve, ndriçuesve dhe sinjalizuesve).
- të përshkruajnë veçoritë dhe përdorimet në mjetet e transportit të elementeve kryesore të skemave elektrike (pajisjeve treguese të parametrave, mbrojtëse, komutuese, komanduese dhe rregulluese);
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e transformatorëve të ndryshëm;
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e motorëve sinkronë dhe asinkronë;
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e gjeneratorëve të ndryshëm;
- të përshkruajnë parimin e punës dhe ndërtimin e akumulatorëve të ndryshëm;
- të përshkruajnë objektin e elektronikës dhe rëndësinë e saj për mjetet e transportit;
- të tregojnë veçoritë dhe përdorimet e gjysëmpërçuesve në mjetet e transportit;
- të dallojnë elementet e ndryshëm të qarqeve elektronike tipike dhe simbolikën e tyre;
- të përshkruajnë veçoritë e skemave tipike me gjysëmpërçues;

- përshkruajnë veçoritë dhe përdorimet në mjetet e transportit të qarqeve të integruara dhe të printuara;
- përshkruajnë veçoritë dhe përdorimet në mjetet e transportit të sensorëve, procesorëve dhe vepruesve (aktuatorëve).

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit” kl. 11 - 68 orë:**

Tema 1	Hyrje në elektroteknikë (hyrje në elektricitet)	2 orë
Tema 2	Madhësitë elektrike dhe matja e tyre	3 orë
Tema 3	Përcjellësit dhe izolatorët e rrymës elektrike	2 orë
Tema 4	Efektet e rrymës elektrike	2 orë
Tema 5	Rreziqet dhe mbrojtja nga rryma elektrike	2 orë
Tema 6	Elementet (simbolet) dhe llojet kryesore të skemave elektrike	5 orë
Tema 7	Zbatime të ligjit të Ohmit	3 orë
Tema 8	Elektromagnetizmi dhe induksioni elektromagnetik	4 orë
Tema 9	Çelësat	2 orë
Tema 10	Rezistencat	2 orë
Tema 11	Bobinat	2 orë
Tema 12	Kondensatorët	2 orë
Tema 13	Ndriçuesit dhe sinjalizuesit	3 orë
Tema 14	Pajisjet treguese të parametrave	2 orë
Tema 15	Pajisjet mbrojtëse (siguresat dhe automatët)	3 orë
Tema 16	Pajisjet e komutimit, komandimit dhe rregullimit	3 orë
Tema 17	Transformatorët	3 orë
Tema 18	Motorët sinkronë dhe asinkronë	4 orë
Tema 19	Gjeneratorët	3 orë
Tema 20	Akumulatorët	2 orë
Tema 21	Hyrje në elektronikë	1 orë
Tema 22	Gjysëmpërçuesit	2 orë
Tema 23	Elementet e qarqeve elektronike	3 orë
Tema 24	Skemat bazë me gjysëmpërçues	4 orë
Tema 25	Qarqet e integruara dhe të printuara	2 orë
Tema 26	Sensorët, procesorët dhe vepruesit	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli: “Punime axhusterie”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Niveli: I

Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME AXHUSTERIE	(M-04-210-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme axhusterie që përdoren në shërbimet e mjeteve të transportit, si dhe matjet përkatëse, me përdorimin e veglave dhe pajisjeve të axhusterisë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranimit	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen matje dhe shënime mekanike.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja e instrumentave matëse dhe shënuese.- Matja me metër.- Matja me kalibër.- Matja me mikrometër.- Matja me komparator.- Matja me këndmatës.- Matja me manometër.- Shënimi me instrumenta shënuese.- Kujdesi për instrumentat matëse dhe shënuese. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë drejt instrumentat matëse dhe shënuese.- të kryejë matje të sakta me metër.- të kryejë matje të sakta me kalibër.- të kryejë matje të sakta me mikrometër.- të kryejë matje të sakta me komparator.- të kryejë matje të sakta me këndmatës.- të kryejë matje të sakta me manometër.- të bëjë shënimet e nevojshme me instrumenta shënuese të llojeve të ndryshme.- të tregojë kujdesin e duhur për instrumentat matëse dhe shënuese.	

RM 2 Nxënësi kryen punime të limimit të sipërfaqeve metalike, të brendëshme dhe të jashtme.

Përmbajtja:

- Analiza e skicës ose vizatimit të detalit metalik.
- Përzgjedhja e copës metalike për limim.
- Përzgjedhja e limave për limim.
- Përzgjedhja e instrumenteve matës dhe shënues gjatë limimit.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në morsë.
- Kryerja e limimeve të sipërfaqeve të rrafshta.
- Kryerja e limimeve të sipërfaqeve të profiluara
- Kryerja e limimeve të sipërfaqeve me kënd.
- Matja dhe shënimi gjatë limimit të sipërfaqeve përkatëse.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë limimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit.
- të përzgjedhë copën metalike të përshtatshme për limim.
- të përzgjedhë limat e duhura për limimet që do të kryhen.
- të përzgjedhë instrumentet e duhura matëse dhe shënuese.
- të vendosë dhe shtrëngojë në mënyrë të rregullt copën në morsë.
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve të rrafshta.
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve cilindrike.
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve të profiluara
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve me kënd.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta gjatë limimit të sipërfaqeve përkatëse.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë limimit.

RM 3 Nxënësi kryen punime të prerjes së copave metalike me vegla dore.

Përmbajtja:

- Analiza e skicës ose e vizatimit të detalit metalik.
- Përzgjedhja e copës që do të pritët.
- Përzgjedhja e metodës për prerjen e copës.
- Përzgjedhja e veglave të punës.
- Përzgjedhja e instrumenteve matëse dhe shënuese.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në pajisjen mbajtëse.
- Teknika e prerjes me sharrë metalike dore.

- Teknika e prerjes me gërshërë dore për fletë metalike.
- Teknika e prerjes me daltë.
- Teknika e prerjes me gur-fleksibël.
- Matjet dhe shënimet gjatë prerjes.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt skicën ose e vizatimin e detalit metalik.
- të përzgjedhë copën e përshtatshme që do të pritët.
- të përzgjedhë metodën e duhur për prerjen e copës.
- të përzgjedhë veglat e duhura të punës.
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshme matëse dhe shënuese.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të copës në pajisjen mbajtëse.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me sharrë metalike dore.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gërshërë për fletë metalike.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me daltë.
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gur-fleksibël.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta gjatë prerjes.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes.

RM 4 Nxënësi kryen punime të detaleve metalike me deformim në të ftohtë, me vegla dore.

Përmbajtja:

- Analiza e skices ose e vizatimit të detalit.
- Përzgjedhja e copës metalike.
- Përzgjedhja e mënyrës së deformimit që do të përdoret.
- Përzgjedhja e veglave të punës.
- Përzgjedhja e instrumenteve matëse dhe shënuese.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në mbajtëse.
- Punimi i copës me anë të përkuljes me vegla dore.
- Punimi i copës me anë të shtypjes (rrahjes) me vegla dore.
- Punimi i copave prej fletësh metalike me anë të kthimit dhe palosjes së fletëve.
- Matja dhe shënimi gjatë punimit të detaleve me deformim në të ftohtë.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurisë teknike e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimit të detaleve metalike me deformim në të ftohtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt skicën ose e vizatimin e detalit.
- të përzgjedhë copën e duhur për punimin e detalit me deformim në të ftohtë.
- të përzgjedhë mënyrën e duhur të deformimit që do të përdoret.
- të përzgjedhë veglat e duhura të punës.
- të përzgjedhë instrumentet e duhura matëse dhe shënuese.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të copës në mbajtëse.
- të zbatojë teknikat e duhura për punimin e copës me anë të përkuljes me vegla dore.
- të zbatojë teknikat e duhura për punimin e copës me anë të shtypjes (rrahjes) me vegla dore.
- të zbatojë teknikat e duhura për punimin e copave prej fletësh metalike me anë të kthimit dhe palosjes së fletëve.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta gjatë punimit të detaleve me deformim në të ftohtë.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurisë teknike e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimit të detaleve metalike me deformim në të ftohtë.

RM 5 Nxënësi kryen shpime, me pajisje shpimi bangoje dhe dore.**Përmbajtja:**

- Analiza e skices ose e vizatimit të detalit.
- Përcaktimi i mënyrës së shpimit të vrimës.
- Përzgjedhja e veglave dhe instrumenteve të punës.
- Përzgjedhja e instrumenteve matëse dhe shënuese
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në mbajtëse.
- Vendosja dhe shtrëngimi i majës shpuese në pajisjen shpuese të bangos ose dorës.
- Përcaktimi i regjimit të shpimit.
- Teknika e shpimit të vrimës me pajisje shpuese bangoje.
- Teknika e shpimit të vrimës me pajisje shpuese dore.
- Kryerja e matjeve dhe shënimeve gjatë shpimit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë shpimit të vrimave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit.
- të përcaktojë drejt mënyrën e shpimit të vrimës.
- të përzgjedhë veglat dhe instrumentet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt instrumentet matëse dhe shënuese.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të copës në mbajtëse.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të majës shpuese

- në pajisjen shpuese të bangos ose të dorës.
- të përcaktojë saktë regjimet e përpunimit të vrimës me shpim.
- të zbatojë teknikat e duhura për shpimin e vrimës me pajisje shpuese të bangos.
- të zbatojë teknikat e duhura për shpimin e vrimës me pajisje shpuese të dorës.
- të bëjë largimin e ashklave gjatë përpunimit.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta gjatë përpunimit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë shpimit të vrimave me pajisje shpimi dore ose bangoje.

RM 6 Nxënësi kryen kalizvarime dhe alezime vrimash me pajisje dore.

Përmbajtja:

- Analiza e skices ose e vizatimit të detalit.
- Përcaktimi i mënyrës së kalizvarimit ose alezimit.
- Përzgjedhja e veglave dhe instrumenteve të punës.
- Përzgjedhja e instrumenteve matëse dhe shënuese.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në mbajtëse.
- Vendosja e kalizvarit ose alezatorit në mbajtësen përkatëse.
- Matja dhe regjistrimi instrumentit.
- Teknika e kalizvarimit të vrimës.
- Teknika e alezimit të vrimës.
- Kryerja e matjeve gjatë përpunimit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë shpimit, zgjerimit dhe alezimit të vrimave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit.
- të përcaktojë drejt mënyrën e kalizvarimit ose alezimit të vrimës.
- të përzgjedhë veglat dhe instrumentet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt instrumentet matëse dhe shënuese.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të copës në mbajtëse.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e duhur të kalizvarit ose alezatorit në pajisjen mbajtëse përkatëse.
- të bëjë matjen e saktë dhe regjistrimin e duhur të instrumentit
- të zbatojë teknikat e duhura për kalizvarimin e vrimës.
- të zbatojë teknikat e duhura për alezimin e vrimës.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta gjatë përpunimit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kalizvarimit dhe alezimit të vrimave me pajisje dore.

RM 7 Nxënësi kryen filetime të jashtme dhe të brendëshme, me pajisje dore.

Përmbajtja:

- Analiza e skicës ose e vizatimit të detalit.
- Përcaktimi i mënyrës dhe parametrave të filetit.
- Përzgjedhja e instrumentave dhe pajisjeve të dorës për filetim.
- Përzgjedhja e instrumentave matëse.
- Vendosja dhe shtrëngimi i copës në mbajtëse (morsë).
- Kryerja e shpimeve të nevojshme në copë, për filetim të brendshëm.
- Përgatitja e pajisjes së dorës për filetim.
- Përgatitja e copës për filetim.
- Teknika e filetit me dore të filetos së brendshme.
- Teknika e filetit me dore të filetos së jashtme.
- Largimi i ashklave.
- Kryerja e matjeve dhe shënimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë filetit me pajisje dore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit.
- të përcaktojë drejt mënyrën dhe parametrat e filetit të brendshëm ose të jashtëm.
- të përzgjedhë drejt instrumentat dhe pajisjet e dorës për filetim.
- të përzgjedhë instrumentat e duhur për matje dhe shënim.
- të vendosë dhe shtrëngojë siç duhet copën në mbajtëse (morsë).
- të bëjë shpimet e nevojshme në copë, për filetim të brendshëm.
- të bëjë përgatitjen e pajisjes së dorës për filetim.
- të bëjë përgatitjen e copës për filetim.
- të zbatojë teknikat dhe kalimet e punimit me dore të filetos së brendshme.
- të zbatojë teknikat dhe kalimet e punimit me dore të filetos së jashtme.
- të bëjë largimin e ashklave.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë filetit me pajisje dore.

RM 8 Nxënësi kryen punime zmerilimi.

Përmbajtja

- Përcaktimi i mënyrës së zmerilimit.
- Përzgjedhja e pajisjes dhe instrumentave të zmerilimit.

- Përgatitja e pajisjes për zmerilim.
- Teknika e zmerilimit të ashpër të copave me letër zmerile.
- Teknika e zmerilimit të copave me gur-zmeril bangoje.
- Teknika e zmerilimit të copave me gur-zmeril dore.
- Kujdesi për pajisjet dhe instrumentat e zmerilimit.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zmerilimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcakojë drejt mënyrën e zmerilimit.
- të përzgjedhë pajisjen dhe instrumentat e duhura të zmerilimit.
- të bëjë përgatitjen e pajisjes për zmerilim.
- të zbatojë teknikat e duhura për zmerilimin e ashpër të copave me letër zmerile.
- të zbatojë teknikat e duhura për zmerilimin e copave me gur-zmeril bangoje.
- të zbatojë teknikat e duhura për zmerilimin e copave me gur-zmeril dore.
- të tregojë kujdesin e duhur për pajisjet dhe instrumentat e zmerilimit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zmerilimit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart axhusterie ose mjedise pune ku kryhen punime të axhusterisë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve kryesore të axhusterisë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të matjes, shënimit, limimit, sharrimit, shpimit, kalizvarimit, alezimit, punimit me deformim, filetimit dhe zmerilimit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës së axhusterisë me vegla dore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në axhusterinë me vegla dore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisë të praktikës së axhusterisë.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune axhusterie.
 - Copa të ndryshme metalike për punime axhusterie.

-
- Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli: “Punime saldimi”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Niveli: I

Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME SALDIMI	(M-04-211-09)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të thjeshta të saldimit me hark elektrik dhe të saldimit me gas, që përdoren në shërbimet e mjeteve të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi parapërgatit saldimit me hark elektrik.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik për saldimit që do të kryhet.- Përzgjedhja e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të punës.- Përgatitja e bangos për saldimit me hark elektrik.- Përzgjedhja e elektrodave për saldimit.- Veshja e uniformës dhe e mjeteve mbrojtëse për saldimit me hark elektrik.- Përgatitja e makinës salduese për saldimit me hark.- Kyerja e matjeve dhe shënimeve në copat që do të saldohen.- Parapërgatitja e copave që do të saldohen për saldimit me hark elektrik.- Vendosja e copave në bangon e saldimit.- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik për saldimit me hark elektrik që do të kryhet.- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet e duhura të punës.- të bëjë përgatitjen e bangos për saldimit me hark.- të përzgjedhë elektrodën e duhura për llojin e saldimit me hark që do të kryhet.- të veshë uniformën dhe mjete mbrojtëse për saldimit me hark elektrik.	

- të përgatitë makinën salduese me parametrat e duhur për saldimin me hark elektrik që do të kryhet.
- të kryejë matje dhe shënime të sakta në copat që do të saldohen.
- të parapërgatitë copat që do të saldohen për saldim me hark elektrik.
- të bëjë vendosjen duhur të copave në bangon e saldimit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi kryen saldime të thjeshta me hark elektrik, me tegel të drejtë.

Përmbajtja:

- Teknika e pikimit me hark elektrik.
- Teknika e saldimit të sheshtë me hark elektrik.
- Teknika e saldimit me mbivënie (një mbi një) me hark elektrik.
- Teknika e saldimit kokë më kokë (ballor) me hark elektrik.
- Teknika e saldimit këndor me hark elektrik.
- Teknika e prerjes së copave metalike me hark elektrik.
- Kontrolli dhe përpunimi përfundimtar i tegelave të saldimit me hark elektrik.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me hark elektrik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të zbatojë procedurat e duhura gjatë pikimit me hark elektrik.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit të sheshtë me hark elektrik.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit me mbivënie (një mbi një) me hark elektrik.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit kokë më kokë (ballor) me hark elektrik.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit këndor me hark elektrik.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë prerjes së copave metalike me hark elektrik.
- të bëjë kontrollin e duhur dhe përpunimin përfundimtar të tegelave të saldimit me hark elektrik.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me hark elektrik.

RM 3 Nxënësi parapërgatit saldimin me gas.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik për saldimit me gas që do të kryhet.
- Veshja e uniformës dhe e mjeteve mbrojtëse për saldimit me gas.
- Përzgjedhja e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të punës.
- Përgatitja e bangos për saldimit me gas.
- Përgatitja për punë e gjeneratorit të acetilenit.
- Përzgjedhja e shufrave të metalit mbushës për saldimit me gas.
- Përzgjedhja dhe montimi i pipës së kanelës.
- Rregullimi i regjimit të saldimit me gas.
- Kyerja e matjeve dhe shënimeve në copat që do të saldohen.
- Parapërgatitja e copave që do të saldohen për saldimit me gas.
- Vendosja e copave në bangon e saldimit me gas.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik për saldimit me gas që do të kryhet.
- të veshë e uniformën dhe e mjeteve mbrojtëse të nevojshme për saldimit me gas.
- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet e duhura të punës.
- të bëjë përgatitjen e bangos për saldimit me gas.
- të bëjë përgatitjen për punë e gjeneratorit të acetilenit.
- të përzgjedhë shufrat e duhura të metalit mbushës për saldimit me gas.
- të përzgjedhë dhe montojë pipën e duhur të kanelës.
- të bëjë rregullimin e regjimit të duhur të saldimit me gas.
- të bëjë matje dhe shënime të sakta në copat që do të saldohen.
- të bëjë parapërgatitjen e copave që do të saldohen për saldimit me gas.
- të vendosë siç duhet copa në bangon e saldimit me gas.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi kryen saldime të thjeshta me gas.

Përmbajtja:

- Teknika e pikimit me gas.
- Teknikat e saldimit të sheshtë me gas.
- Teknikat e saldimit me mbivënie (një mbi një) me gas.
- Teknikat e saldimit kokë më kokë (ballor) me gas.
- Teknikat e saldimit këndor me gas.
- Teknikat e prerjes së copave metalike me gas.
- Kontrolli dhe përpunimi përfundimtar i tegelave të saldimit

me gas.

- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me hark elektrik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të zbatojë procedurat e duhura gjatë pikimit me gas.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit të sheshtë me gas.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit me mbivënie (një mbi një) me gas.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit kokë më kokë (ballor) me gas.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë saldimit këndor me gas.
- të zbatojë procedurat e duhura gjatë prerjes së copave metalike me gas.
- të bëjë kontrollin e duhur dhe përpunimin përfundimtar të tegelave të saldimit me gas.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit me gas.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart saldimit ose në mjedis pune ku kryhen punime të saldimit me hark elektrik dhe me gas.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të saldimeve kryesore me hark elektrike dhe me gas.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të parapërgatitjes dhe të realizimit të saldimeve me pikim, të sheshta, kokë më kokë, me mbivënie, këndore dhe të prerjes me saldimit me hark dhe me gas, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës së saldimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e teknikave të duhura të saldimit me hark elektrik dhe me gas.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset të praktikës së saldimit me hark elektrik dhe me gas.
 - Aparatet saldimit me hark elektrik dhe me gas.
 - Materialet e nevojshme për saldimit me hark elektrik dhe me gas.
 - Kompletin e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe saldime me hark elektrik dhe me gas.
-

-
- Copa të ndryshme metalike për punime saldimi.
 - Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme për saldim.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli: “Punime zmontimi dhe montimi në automjete”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti

Niveli: I

Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME ZMONTIMI DHE MONTIMI NE AUTOMJETE	(M-18-212-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme të zmontimit dhe montimit të agregateve kryesore nga automjetet.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi zmonton agregatet kryesore nga automjeti.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik të automjetit.- Përcaktimi i rradhës së punës për zmontimin.- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për zmontim.- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zmontim.- Procedura e zmontimit të motorit nga automjeti.- Procedura e zmontimit të freksionit nga automjeti.- Procedura e zmontimit të kutisë së shpejtësisë nga automjeti.- Procedura e zmontimit të transmisionit kardanic nga automjeti.- Procedura e zmontimit të urave nga automjeti.- Procedura e zmontimit të grupit të timonit nga automjeti.- Procedura e zmontimit të rrotave nga automjeti.- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zmontimit të agregateve kryesore nga automjeti. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të automjetit.- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zmontim.- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për zmontim.- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zmontim.- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të motorit nga automjeti.- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të freksionit nga automjeti.
---	---

- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të kutisë së shpejtësisë nga automjeti.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të transmisionit kardanic nga automjeti.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të urave nga automjeti.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të grupit të timonit nga automjeti.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të rrotave nga automjeti.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zmontimit të agregateve kryesore nga automjeti.

RM 2 Nxënësi monton agregatet kryesore në automjet.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për montimin.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për montim.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për montim.
- Procedura e montimit të motorit në automjet.
- Procedura e montimit të freksionit në automjet.
- Procedura e montimit të kutisë së shpejtësisë në automjet.
- Procedura e montimit të transmisionit kardanic në automjet.
- Procedura e montimit të urave në automjet.
- Procedura e montimit të grupit të timonit në automjet.
- Procedura e montimit të rrotave në automjet.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të agregateve kryesore në automjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të automjetit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për montim.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për montim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për montim.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të motorit në automjet.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të freksionit në automjet.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të kutisë së shpejtësisë në automjet.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të transmisionit kardanic në automjet.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të urave në automjet.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të grupit të

- timonit në automjet.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të rrotave në automjet.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të agregateve kryesore në automjet.

RM 3 Nxënësi zmonton pjesët kryesore të motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zmontimin e pjesëve të motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për zmontimin e pjesëve të motorit.
- Përgatitja e motorit dhe e vendit të punës për zmontim.
- Procedura e zmontimit të elementeve të sistemit të ushqimit.
- Procedura e zmontimit të elementeve të sistemit të ftohjes.
- Procedura e zmontimit të elementeve të sistemit të ndezjes.
- Procedura e zmontimit të kokës së motorit.
- Procedura e zmontimit të nënkarterit.
- Procedura e zmontimit të elementeve të sistemit të vajisjes.
- Procedura e zmontimit të boshtit me gunga dhe elementeve të shpërndarjes së gazeve.
- Procedura e zmontimit të boshtit të motorit.
- Procedura e zmontimit të grupit pistoni-cilindër.
- Sistemimi i pjesëve të zmontuara të motorit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zmontimit të pjesëve kryesore të motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zmontimin e pjesëve të motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për zmontimin e pjesëve të motorit.
- të përgatitë motorin dhe vendin e punës për zmontim.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të elementeve të sistemit të ushqimit.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të elementeve të sistemit të ftohjes.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të elementeve të sistemit të ndezjes.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të kokës së motorit.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të nënkarterit.
- të zbatojë procedurat e zmontimit të elementeve të sistemit

- të vajisjes.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të boshtit me gunga dhe elementeve të shpërndarjes së gazeve.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të boshtit të motorit.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të grupit piston-cilindër.
- të sistemojë si duhet pjesët e zmontuara të motorit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zmontimit të pjesëve kryesore të motorit.

RM 4 Nxënësi monton pjesët kryesore të motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për montimin e pjesëve të motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për montimin e pjesëve të motorit.
- Përgatitja e vendit të punës për montimin e pjesëve të motorit.
- Procedura e montimit të grupit pistoni-cilindër.
- Procedura e montimit të boshtit të motorit.
- Procedura e montimit të boshtit me gunga dhe elementeve të shpërndarjes së gazeve.
- Procedura e montimit të elementeve të sistemit të vajisjes.
- Procedura e montimit të nënkarterit.
- Procedura e montimit të kokës së motorit.
- Procedura e montimit të elementeve të sistemit të ndezjes.
- Procedura e montimit të elementeve të sistemit të ftohjes.
- Procedura e montimit të elementeve të sistemit të ushqimit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të pjesëve kryesore të motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për montimin e pjesëve të motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për montimin e pjesëve të motorit.
- të përgatitë vendin e punës për montimin e pjesëve të motorit.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të grupit piston-cilindër.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të boshtit të motorit.

- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të boshtit me gunga dhe elementeve të shpërndarjes së gazeve.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të elementeve të sistemit të vajisjes.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të nënkarterit.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të kokës së motorit.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të elementeve të sistemit të ndezjes.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të elementeve të sistemit të ftohjes.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të elementeve të sistemit të ushqimit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë montimit të pjesëve kryesore të motorit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime zmontim-montimit të pjesëve të automjeteve.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të zmontim-montimit të pjesëve të automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të zmontim-montimit të pjesëve të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të zmontim-montimit të pjesëve të automjeteve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisë të praktikës së zmontim-montimit.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për zmontim-montimin e pjesëve të automjeteve.
 - Automjet mësuesor.
 - Agregate të automjeteve.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Punime në friksionet dhe kutitë e shpejtësisë së automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti

Niveli: I

Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NE FRIKSIONET DHE KUTITE E SHPEJTESISE SE AUTOMJETEVE	(M-18-721-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në friksionet mekanike dhe në kutitë ndërrimit të shpejtësisë (KNSH) manuale së automjeteve.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi mirëmban friksionet mekanike të automjeteve. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik të automjetit dhe friksionit mekanik.- Përcaktimi i rradhës së punës për mirëmbajtjen e friksionit.- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për mirëmbajtjen.- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për mirëmbajtjen e friksionit.- Kryerja e matjeve dhe kontrolleve për verifikimin e mirëfeksionimit të friksionit mekanik.- Kryerja e shtrëngimeve të mbërthimeve me fileto.- Procedura e regjistrimeve të nevojshme në friksion dhe mekanizmin e komandimit.- Procedura e regjistrimit të korsës së lirë të pedalit të friksionit.- Kryerja e vasisjeve dhe grasatimeve të nevojshme në friksion dhe mekanizmin e komandimit.- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.- Prova e funksionimit të friksionit mekanik.- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të mirëmbajtjes së friksioneve mekanike të automjeteve. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të automjetit dhe	

-
- friksionit mekanik.
 - të përcaktojë saktë rradhën e punës për mirëmbajtjen e friksionit.
 - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për mirëmbajtjen e friksionit.
 - të përgatitë si duhet automjetin dhe vendin e punës për mirëmbajtjen e friksionit.
 - të kryejë matje të sakta dhe kontrole të kujdesëshme për verifikimin e mirëfunktionimit të friksionit mekanik.
 - të shtrëngojë sa duhet mbërthimet me fileto.
 - të kryejë regjistrimet e duhura në friksionin mekanik dhe në mekanizmin e komandimit.
 - të kryejë regjistrimin e duhur të korsës së lirë të pedalit të friksionit.
 - të bëjë vajtjet dhe grasatimet e nevojshme në friksion dhe në mekanizmin e komandimit.
 - të kryejë pastrimet e nevojshme në friksion.
 - të bëjë provën e funksionimit të friksionit mekanik.
 - të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të mirëmbajtjes së friksioneve mekanike të automjeteve.

RM 2 Nxënësi kryen punime të zëvendësimit në friksionet mekanike.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të friksionit mekanik.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zmontimin e friksionit dhe të pjesëve të tij.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për punimet e zëvendësimit të pjesëve të friksionit mekanik.
- Përgatitja e automjetit dhe e vendit të punës për punime në friksion.
- Procedura e zmontimit të friksionit mekanik nga trupi i motorit.
- Procedura e zmontimit të pjesëve të friksionit mekanik.
- Kontrolli dhe matja e detaleve dhe nyjeve të zmontuara të friksionit mekanik.
- Identifikimi i pjesëve që duhet të zëvendësohen.
- Përzgjedhja e pjesëve të reja që do të montohen në friksionin mekanik.
- Përcaktimi i rradhës së punës për montimin të pjesëve friksionit dhe të vetë friksionit mekanik.
- Procedura e montimit të pjesëve të friksionit mekanik.
- Procedura e montimit të friksionit mekanik në trupin e motorit.
- Kryerja e regjistrimeve në friksionin mekanik.
- Prova e funksionimit të friksionit mekanik të montuar.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë

zëvendësimin të pjesëve të friksionit mekanik në automjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të friksionit mekanik.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zmontimin e friksionit dhe të pjesëve të tij.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për punimet e zëvendësimit të pjesëve të friksionit mekanik.
- të përgatitë si duhet automjetin dhe vendin e punës për punime në friksion.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të friksionit mekanik nga trupi i motorit.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të pjesëve të friksionit mekanik.
- të kontrollojë dhe të matë saktë detalet dhe nyjet e zmontuara të friksionit mekanik.
- të identifikojë saktë pjesët që duhet të zëvendësohen.
- të përzgjedhë pjesët e reja që do të montohen në friksionin mekanik.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për montimin e pjesëve të friksionit dhe të vetë friksionit mekanik.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të pjesëve të friksionit mekanik.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të friksionit mekanik në trupin e motorit.
- të kryejë saktë regjistrimet në friksionin mekanik.
- të kryejë provën e funksionimit të friksionit mekanik të montuar.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të friksionit mekanik në automjet

RM 3 Nxënësi kryen punime të zëvendësimit në mekanizmin mekanik të komandimit të friksionit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të friksionit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zmontimin e pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për punimet e zëvendësimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Përgatitja e automjetit dhe e vendit të punës për punime në mekanizmin e komandimit të friksionit.
- Procedura e zmontimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Kontrolli dhe matja e detaleve dhe nyjeve të zmontuara të

- mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Identifikimi i pjesëve që duhet të zëvendësohen.
- Përzgjedhja e pjesëve të reja që do të montohen në mekanizmin mekanik të komandimit të friksionit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për montimin të pjesëve mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Procedura e montimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Kryerja e regjistrimeve në mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Prova e funksionimit të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit në automjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të friksionit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zmontimin e pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për punimet e zëvendësimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për punime në mekanizmin e komandimit të friksionit.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- të kontrollojë dhe të matë saktë detalet dhe nyjet e zmontuara të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- të identifikojë saktë pjesët që duhet të zëvendësohen.
- të përzgjedhë drejt pjesët e reja që do të montohen në mekanizmin mekanik të komandimit të friksionit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për montimin të pjesëve mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- të kryejë saktë regjistrimet në mekanizmin mekanik të komandimit të friksionit.
- të kryejë provat e funksionimit të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të mekanizmit mekanik të komandimit të friksionit mekanik.

RM 4 Nxënësi mirëmban KNSH manuale të automjeteve.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të automjetit dhe KNSH manuale.
- Përcaktimi i rradhës së punës për mirëmbajtjen e KNSH manuale.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për mirëmbajtjen.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për mirëmbajtjen e KNSH manuale.
- Kryerja e matjeve dhe kontrolleve për verifikimin e mirëfeksionimit të KNSH manuale.
- Procedura e zbrazjes së vajit të vjetëruar të KNSH manuale.
- Procedura e hedhjes së vajit të ri në KNSH manuale.
- Kryerja e shtrëngimeve të mbërthimeve me fileto.
- Procedura e regjistrimeve të nevojshme në KNSH dhe mekanizmin e komandimit manual.
- Kryerja e grasatimeve të nevojshme në KNSH manuale.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Prova e funksionimit të KNSH manuale.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të mirëmbajtjes së KNSH manuale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionit teknik të automjetit dhe të KNSH manuale.
- të përcaktojë saktë rradhën e punës për mirëmbajtjen e KNSH manual.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për mirëmbajtjen e KNSH manuale.
- të përgatitë si duhet automjetin dhe vendin e punës për mirëmbajtjen e KNSH manuale.
- të kryejë matje të sakta dhe kontrolle të kujdesëshme për verifikimin e mirëfeksionimit të KNSH manuale.
- të zbatojë procedurat e duhura të zbrazjes së vajit të vjetëruar të KNSH manuale.
- të zbatojë procedurat e duhura të hedhjes së vajit të ri në KNSH manuale
- të shtrëngojë sa duhet mbërthimet me fileto.
- të kryejë regjistrimet e duhura në KNSH manuale dhe në mekanizmin e komandimit.
- të bëjë grasatimet e nevojshme në KNSH manuale dhe në mekanizmin e komandimit.
- të kryejë pastrimet e nevojshme në KNSH manuale.
- të bëjë provën e funksionimit të KNSH manuale.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të mirëmbajtjes së KNSH manuale të

automjeteve.

RM 5 Nxënësi kryen punime të zëvendësimit në KNSH manuale të automjeteve.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të KNSH manuale.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zmontimin e KNSH manual të pjesëve të tij.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për punimet e zëvendësimit të pjesëve të KNSH manuale.
- Përgatitja e automjetit dhe e vendit të punës për punime në KNSH manuale.
- Procedura e zbrazjes së vajit nga KNSH manuale.
- Shkëputja e lidhjeve elektrike dhe mekanike nga KNSH manuale.
- Procedura e zmontimit të KNSH manuale nga agregatet e tjerë.
- Procedura e zmontimit të pjesëve të KNSH manuale dhe të mekanizmit të komandimit.
- Kontrolli dhe matja e detaleve dhe nyjeve të zmontuara të KNSH manuale dhe mekanizmit të komandimit.
- Identifikimi i pjesëve që duhet të zëvendësohen.
- Përzgjedhja e pjesëve të reja që do të montohen në KNSH manuale dhe mekanizmin e komandimit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për montimin të pjesëve KNSH manuale dhe mekanizmit të komandimit.
- Procedura e montimit të pjesëve të KNSH manuale dhe mekanizmit të komandimit.
- Procedura e montimit të KNSH manuale me agregatet e tjera.
- Montimi i lidhjeve elektrike dhe mekanike të KNSH manuale.
- Procedura e hedhjes së vajit në KNSH manuale.
- Kryerja e regjistrimeve në KNSH manuale dhe në mekanizmin e komandimit.
- Prova e funksionimit të KNSH manuale të montuar.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të KNSH manuale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të KNSH manuale.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zmontimin e KNSH manuale dhe të pjesëve të saj.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për punimet e zëvendësimit të pjesëve të KNSH manuale.
- të përgatitë si duhet automjetin dhe vendin e punës për punime në KNSH manuale.

- të zbatojë procedurat e duhura të zbrazjes së vajit nga KNSH manuale.
- të bëjë shkëputjen e lidhjeve elektrike nga KNSH manuale.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të KNSH manuale nga agregatet e tjera.
- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të pjesëve të KNSH manuale dhe të mekanizmit të komandimit.
- të kontrollojë dhe të matë saktë detalet dhe nyjet e zmontuara të KNSH manuale dhe të mekanizmit të komandimit.
- të identifikojë saktë pjesët që duhet të zëvendësohen.
- të përzgjedhë pjesët e reja që do të montohen në KNSH manuale dhe në mekanizmin e komandimit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për montimin e pjesëve të KNSH manuale dhe të mekanizmit të komandimit.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të pjesëve të KNSH manuale dhe të mekanizmit të komandimit.
- të zbatojë procedurat e duhura të montimit të KNSH manuale me agregatet e tjera.
- të bëjë montimin e lidhjeve elektrike të KNSH manuale.
- të zbatojë procedurat e duhura të hedhjes së vajit në KNSH manuale.
- të kryejë saktë regjistrimet në KNSH manuale dhe mekanizmin e komandimit.
- të kryejë montimin e lidhjeve elektrike të KNSH manuale.
- të kryejë provën e funksionimit të KNSH manuale të montuar.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të KNSH manuale të automjetit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në friksionet mekanike dhe KNSH manuale të automjeteve.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në friksionet mekanike dhe KNSH manuale të automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në friksionet mekanike dhe KNSH manuale të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në

friksionet mekanike dhe KNSH manuale të automjeteve.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në friksionet mekanike dhe KNSH manuale të automjeteve.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zëvendësimin në friksionet mekanike dhe KNSH manuale të automjeteve.
 - Automjet mësimor me friksion mekanik dhe KNSH manuale.
 - Detale dhe nyje të friksioneve mekanike dhe KNSH manuale.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Punime në rrotat e automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti

Niveli: I

Klasa: 10

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NE RROTAT E AUTOMJETEVE	(M-18-215-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të përcaktuar dëmtimet kryesore në rrotat e automjeteve, për të riparuar gomat e dëmtuara, për të zëvendësuar kushinetat e rrotave dhe për të bërë ballancimin statik dhe dinamik të rrotave të automobilave.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përcakton dëmtimet në rrotat e automjeteve.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik të automjetit dhe të rrotave.- Vendosja e automjetit në vendin e punës (pajisjen ngritëse) për riparimin e rrotave.- Lirimi paraprak i dadiçekëve (bulonave të shtrëngimit).- Ngritja e automjetit me pajisjen ngritëse.- Lirimi i plotë i dadiçekëve.- Heqja e rrotës nga aksi.- Fryrja e gomës (nëse është e nevojshme).- Përcaktimi i dëmtimeve në gomë, disk ose aks.- Përcaktimi i mënyrës së riparimit të rrotës.- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe materialeve për riparimin e rrotës.- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të përcaktimit të dëmtimeve në rrotat e automjeteve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të automjetit dhe të rrotave.- të vendosë automjetin në vendin e punës (pajisjen ngritëse) për riparimin e rrotave.- të kryejë lirimin paraprak të dadiçekëve (bulonave të	

shtrengimit).

- të ngrejë në mënyrë të sigurtë automjetin me pajisjen ngritëse.
- të kryejë lirimimin e plotë të dadiçekëve.
- të heqë rrotën nga aksi.
- të fryjë sa duhet gomën (nëse është e nevojshme).
- të përcaktojë dëmtimet në gomë, në disk ose në aks.
- të përcaktojë saktë mënyrën e riparimit të rrotës.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për riparimin e rrotës.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të përcaktimit të dëmtimeve në rrotat e automjeteve.

RM 2 Nxënësi riparon gomat e dëmtuara.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të gomës.
- Përcaktimi i llojit dhe zonës të shpimit të gomës.
- Procedura e ngjitjes së gomës me fitil (për dëmtime të vogla)
- Parapërgatitja (zmerilimi) e zonës së gomës që do të riparohet (për dëmtime të mëdha).
- Procedura e pastrimit lyerjes me ngjitës të zonës së dëmtuar
- Procedura e vendosjes së pullës ngjitëse në zonën e dëmtuar.
- Lyerja e unazës së takimit të diskut me gomën, me pastë hermetizuese.
- Procedura e vendosjes së gomës në disk.
- Fryrja e gomës.
- Kontrolli i hermeticitetit të gomës së riparuar.
- Montimi i gomës së riparuar në aks.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të friksionit mekanik në automjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të gomës.
- të përcaktojë saktë llojin dhe zonën e shpimit të gomës.
- të zbatojë procedurat e duhura të ngjitjes së gomës me fitil (për dëmtime të vogla)
- të parapërgatitë (zmerilojë) si duhet zonën e gomës që do të riparohet (për dëmtime të mëdha).
- të zbatojë procedurat e duhura të pastrimit e të lyerjes me ngjitës të zonës së dëmtuar
- të zbatojë procedurat e duhura të vendosjes së pullës ngjitëse në zonën e dëmtuar.
- të kryejë lyerjen e unazës së takimit të diskut me gomën, me pastë hermetizuese.
- të zbatojë procedurat e duhura të vendosjes së gomës në

- disk.
- të fryjë sa duhet gomën.
- të kontrollojë hermeticitetin e gomës së riparuar.
- të montojë gomën e riparuar në aks.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të gomave të dëmtuara në automjet.

RM 3 Nxënësi zëvendëson kushinetën e dëmtuar të rrotës.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të rrotës.
- Përcaktimi i llojit dhe shkallës së dëmtimit të kushinetës së rrotës.
- Heqja e mbulesës së diskut (tasit)
- Procedura e zmontimit të diskut të rrotës me kushinetën e dëmtuar.
- Procedura e zmontimit të mocos së rrotës nga aksi me kushinetën e dëmtuar.
- Procedura e heqjes së kushinetës së dëmtuar.
- Procedura e vendosjes së kushinetës së re.
- Kryerja e grasatimit të kushinetës.
- Procedura e montimit të mocos së rrotës në aks.
- Regjistrimi i kushinetës së zëvendësuar
- Procedura e montimit të rrotës në moco.
- Vendosja e mbulesës së diskut (tasit).
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të kushinetës së rrotës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të rrotës.
- të përcaktojë llojin dhe shkallën e dëmtimit të kushinetës së rrotës.
- të heqë mbulesën e diskut (tasit)
- të zbatojë procedurat e zmontimit të diskut të rrotës me kushinetën e dëmtuar.
- të zbatojë procedurat e zmontimit të mocos së rrotës nga aksi me kushinetën e dëmtuar.
- të zbatojë procedurat e heqjes së kushinetës së dëmtuar.
- të zbatojë procedurat e vendosjes së kushinetës së re.
- të kryejë grasatimin e kushinetës.
- të zbatojë procedurat e montimit të mocos së rrotës në aks.
- të bëjë regjistrimin e kushinetës së zëvendësuar
- të zbatojë procedurat e montimit të rrotës në moco.
- të vendosë mbulesën e diskut (tasit).
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të kushinetës së rrotës

RM 4 Nxënësi balancon rrotat e automjeteve.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të automjetit.
- Procedura e zmontimit të rrotës që do të balancohet.
- Vendosja e rrotës që do të balancohet në makinën e balancimit.
- Rregullimi i parametrave të makinës për balancim të rrotës.
- Përcaktimi i pozicionit dhe shkallës së mos-ballancimit të rrotës.
- Vendosja e kundrapeshave për balancim.
- Rikontrolli i balancimit deri në balancim të plotë.
- Heqja e rrotës së balancuar nga makina balancuese.
- Montimi i rrotës në automobil.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë balancimit të rrotës së automobilit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të automjetit.
- të zbatojë procedurat e zmontimit të rrotës që do të balancohet.
- të vendosë rrotën që do të balancohet në makinën e balancimit.
- të kryejë rregullimin e parametrave të makinës për balancimin e rrotës.
- të përcaktojë pozicionin dhe shkallën e mos-ballancimit të rrotës.
- të vendosë kundrapesha për balancim.
- të kryejë rikontrollin e balancimit deri në balancim të plotë.
- të heqë rrotën e balancuar nga makina balancuese.
- të montojë rrotën në automobil.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë balancimit të rrotës së automobilit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të mirëmbajtjes dhe riparimit të rrotave të automjeteve.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të mirëmbajtjes dhe riparimit të rrotave të automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të riparimit të gomave, zëvendësimit të kushinetave dhe balancimit të rrotave të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.

-
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të mirëmbajtjes dhe riparimit të rrotave të automjeteve.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së mirëmbajtjes dhe riparimit të rrotave të automjeteve.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zëvendësimin dhe riparimin e rrotave të automjeteve.
 - Automjet mësimor.
 - Makinë balancimi rrotash.
 - Pjesë të rrotave të automjeteve.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli “Punime kryesore në sistemet e motorëve të automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Niveli: I

Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME KRYESORE NE SISTEMET E MOTOREVE TE AUTOMJETEVE	(M-18-216-15)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në sistemet e motorëve “Otto” dhe “Diesel” të automjeteve të lehta.	
Kohëzgjatja e modulit	85 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zëvendëson vajin dhe filtrin e vajit të motorit të automjetit. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e vajit dhe filtrit të vajit të motorit.- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.- Përzgjedhja e vajit dhe filtrit të vajit.- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e vajit dhe filtrit të vajit të motorit.- Procedura e zbrazjes së vajit të vjetëruar.- Zmontimi i filtrit të vajit të përdorur.- Montimi i filtrit të ri të vajit.- Procedura e hedhjes së vajit të ri.- Ndezja e motorit dhe kontrolli për rrjedhje vaji.- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të vajit dhe filtrit të vajit të motorit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.- të përcaktojë saktë rradhën e punës për zëvendësimin e vajit dhe filtrit të vajit të motorit.- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.- të përzgjedhë drejt vajin dhe filtrin e vajit.	

-
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e vajit dhe filtrit të vajit të motorit.
 - të zbatojë procedurat e duhura të zbrazjes së vajit të vjetëruar.
 - të zmontojë filtrin e vajit të përdorur.
 - të montojë si duhet filtrin e ri të vajit.
 - të zbatojë drejt procedurat e hedhjes së vajit të ri.
 - të kryejë ndezjen e motorit dhe kontrollin për rrjedhje vaji.
 - të kryejë pastrimet e nevojshme.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të vajit dhe filtrit të vajit të motorit.

RM 2 Nxënësi zëvendëson nënkarterin e motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e nënkarterit të motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e nënkarterit dhe guarnicionit hermetizues.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e nënkarterit të motorit.
- Zbrazja dhe mbledhja në enë e vajit të sistemit të vajisjes së motorit.
- Zmontimi i nënkarterit dhe guarnicionit të nënkarterit.
- Pastrimi dhe lyerja me lëndë hermetizuese e sipërfaqes së kontaktit të pjesës së poshtme të karterit të motorit, me guarnicionin e nënkarterit.
- Pastrimi dhe lyerja me lëndë hermetizuese e sipërfaqes së kontaktit të pjesës së sipërme të nënkarterit të motorit, me guarnicionin e nënkarterit.
- Vendosja e guarnicionit dhe nënkarterit në pjesën e poshtme të karterit të motorit.
- Montimi i nënkarterit dhe guarnicionit.
- Hedhja e vajit në motor.
- Kontrolli për rrjedhje të vajit.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të nënkarterit të motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë saktë rradhën e punës për zëvendësimin e nënkarterit të motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë nënkarterin dhe guarnicionin hermetizues.

- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e nënkarterit të motorit.
- të zbrazë dhe të mbledhë në enë vajin e sistemit të vajisjes së motorit.
- të zmontojë nënkarterin dhe guarnicionin e nënkarterit.
- të pastrojë mirë dhe të lyejë me lëndë hermetizuese sipërfaqen e kontaktit të pjesës së poshtme të karterit të motorit, me guarnicionin e nënkarterit.
- të pastrojë mirë dhe të lyejë me lëndë hermetizuese sipërfaqen e kontaktit të pjesës së sipërme të nënkarterit të motorit, me guarnicionin e nënkarterit.
- të vendosë guarnicionin dhe nënkarterin në pjesën e poshtme të karterit të motorit.
- të montojë si duhet nënkarterin dhe guarnicionin.
- të hedhë sasinë e duhur të vajit në motor.
- të kontrollojë për rrjedhje të vajit.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të nënkarterit të motorit.

RM 3 Nxënësi zëvendëson filtrin e ajrit dhe filtrin e lëndës djegëse të motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
 - Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e filtrit të ajrit dhe filtrit të lëndës djegëse të motorit.
 - Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
 - Përzgjedhja e filtrit të ajrit dhe filtrit të lëndës djegëse.
 - Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e filtrit të ajrit dhe filtrit të lëndës djegëse të motorit.
- a) Për zëvendësimin e filtrit të ajrit:
- Zmontimi i kapakut të folesë së filtrit të ajrit.
 - Heqja e filtrit të ajrit të përdorur.
 - Pastrimi i folesë së filtrit të ajrit.
 - Vendosja në fole e filtrit të ri të ajrit.
 - Montimi i kapakut të folesë së filtrit të ajrit.
- b) Për zëvendësimin e filtrit të lëndës djegëse:
- Shkëputja e tubave të dërgimit dhe largimit të lëndës djegëse nga filtri i lëndës djegëse.
 - Zmontimi i filtrit të lëndës djegëse të përdorur.
 - Montimi i filtrit të ri të lëndës djegëse.
 - Montimi i tubave të dërgimit dhe largimit të lëndës djegëse te gypat e filtrit të lëndës djegëse.
 - Vënia në funksionim e motorit me motorino deri në largimin e plotë të ajrit nga sistemi i ushqimit dhe punën uniforme e motorit.
 - Kontrolli i montimit të filtrit për rrjedhje të lëndës djegëse.
 - Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
 - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.

- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe filtrit të lëndës djegëse të motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë saktë rradhën e punës për zëvendësimin e filtrit të ajrit dhe filtrit të lëndës djegëse të motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhur të punës.
- të përzgjedhë drejt filtrin e ajrit dhe filtrin e lëndës djegëse.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e filtrit të ajrit dhe filtrit të lëndës djegëse të motorit.

a) Për zëvendësimin e filtrit të ajrit:

- të zmontojë kapakun e folesë së filtrit të ajrit.
- të heqë filtrin e ajrit të përdorur.
- të pastrojë mirë folenë e filtrit të ajrit.
- të vendosë si duhet në fole filtrin e ri të ajrit.
- të montojë si duhet kapakun e folesë së filtrit të ajrit.

b) Për zëvendësimin e filtrit të lëndës djegëse:

- të shkëpusë tubat e dërgimit dhe largimit të lëndës djegëse nga filtri i lëndës djegëse.
- të zmontojë filtrin e lëndës djegëse të përdorur.
- të montojë si duhet filtrin e ri të lëndës djegëse.
- të montojë tubat e dërgimit dhe largimit të lëndës djegëse te gypat e filtrit të lëndës djegëse.
- të vërë në funksionim motorin me motorino deri në largimin e plotë të ajrit nga sistemi i ushqimit dhe fillimin e punës uniforme të motorit.
- të kontrollojë montimin e filtrit për rrjedhje të lëndës djegëse.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe filtrit të lëndës djegëse të motorit.

RM 4 Nxënësi zëvendëson lëngun ftohës të sistemit të ftohjes së motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e lëngut ftohës të sistemit të ftohjes së motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e lëngut ftohës.
- Zbrazja e lëngut ftohës të përdorur.
- Shplarja/pastrimi me ujë me presion i radiatorit dhe rrugëve të kalimit të lëngut ftohës.
- Hedhja e lëngut ftohës të ri.

- Prova e funksionimit të sistemit të ftohjes dhe kontrolli për rrjedhje.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të lëngut ftohës të sistemit të ftohjes së motorit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zëvendësimin e lëngut ftohës të sistemit të ftohjes së motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhur të punës.
- të përzgjedhë drejt lëngun ftohës.
- të zbrazë lëngun ftohës të përdorur.
- të bëjë shplarjen/pastrimin me ujë me presion të radiatorit dhe rrugëve të kalimit të lëngut ftohës.
- të hedhë sasinë e duhur të lëngut ftohës të ri.
- të kryejë provën e funksionimit të sistemit të ftohjes dhe kontrollin për rrjedhje.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të lëngut ftohës të sistemit të ftohjes së motorit

RM 5 Nxënësi zëvendëson termostatin e sistemit të ftohjes së motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e termostatit të sistemit të ftohjes së motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e termostatit të ri.
- Lirimi i vidave të kapakut të folesë së termostatit.
- Heqja e termostatit të dëmtuar.
- Vendosja në fole termostatit të ri të sistemit të ftohjes.
- Montimi i kapakut të folesë së termostatit.
- Ndezja e motorit dhe prova e funksionimit të termostatit të ri të montuar.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të termostatit të sistemit të ftohjes së motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zëvendësimin e

- termostatit të sistemit të ftohjes së motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt termostatit e ri.
- të kryejë lirimimin e vidave të kapakut të folesë së termostatit.
- të heqë termostatit e dëmtuar.
- të vendosë në fole termostatit e ri të sistemit të ftohjes.
- të montojë si duhet kapakun e folesë së termostatit.
- të ndezë motorin dhe të kryejë provën e funksionimit të termostatit të ri të montuar.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të termostatit të sistemit të ftohjes së motorit.

RM 6 Nxënësi zëvendëson tubat prej gome të sistemit të ftohjes së motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e tubave prej gome të sistemit të ftohjes.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e tubit të ri për zëvendësim.
- Lirimi i fashetave shtrënguese të tubit prej gome të dëmtuar.
- Heqja e tubit të dëmtuar.
- Pastrimi i pjesës së tubit metalik ku do të futet tubi prej gome.
- Lyerja me lëndë hermetizuese e sipërfaqes ku do të bëhet bashkimi.
- Futja e tubit të gomës në tubat metalike.
- Shtrëngimi i fashetave shtrënguese.
- Kontrolli i hermeticitetit të tubit prej gome të montuar.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të termostatit të sistemit të ftohjes së motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- **Vëzhgim me listë kontrolli.**

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zëvendësimin e tubave prej gome të sistemit të ftohjes.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt tubin e ri për zëvendësim.
- të kryejë lirimimin e fashetave shtrënguese të tubit prej gome të dëmtuar.
- të heqë tubin e dëmtuar.
- të pastrojë mirë pjesën e tubit metalik ku do të futet tubi prej gome.
- të lyejë me lëndë hermetizuese sipërfaqen ku do të bëhet bashkimi.

- të kryejë futjen e tubit të gomës në tubat metalike.
- të kryejë shtrëngimin e duhur të fashetave shtrënguese.
- të kontrollojë hermeticitetin e tubit prej gome të montuar.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të termostatit të sistemit të ftohjes së motorit

RM 7 Nxënësi zëvendëson pompën e ujit sistemit të ftohjes së motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e pompës së ujit të sistemit të ftohjes së motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e pompës së re.
- Zbrazja e lëngut ftohës nga sistemi i ftohjes.
- Zmontimi i rrypit të pulexhos së pompës.
- Zmontimi i pulexhos së pompës.
- Zmontimi i tubave që lidhin pompën me sistemin.
- Zmontimi i pompës.
- Heqja e guarnicionit hermetizues.
- Pastrimi i sipërfaqes së takimit të guarnicionit hermetizues.
- Lyerja e me hermetizues sipërfaqes së takimit.
- Vendosja e guarnicionit të ri hermetizues.
- Montimi i pompës së re.
- Bashkimi i tubave lidhës me pompën.
- Montimi i pulexhos së pompës.
- Montimi i rrypit të pulexhos së pompës.
- Regjistrimi i shtrëngimit të rrypit të pulexhos së pompës.
- Mbushja e sistemit të ftohjes me lëng ftohës.
- Prova e funksionimit të pompës së zëvendësuar.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pompës së ujit të sistemit të ftohjes së motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zëvendësimin e pompës së ujit të sistemit të ftohjes së motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt pompën e re.
- të zbrazë lëngun ftohës nga sistemi i ftohjes.
- të zmontojë rrypin e pulexhos së pompës.
- të zmontojë pulexhon e pompës.
- të zmontojë tubat që lidhin pompën me sistemin.
- të zmontojë pompën.

- të heqë guarnicionin hermetizues.
- të pastrojë sipërfaqen e takimit të guarnicionit hermetizues.
- të lyejë me hermetizues sipërfaqen e takimit.
- të vendosë si duhet guarnicionine ri hermetizues.
- të montojë si duhet pompën e re.
- të kryejë bashkimin e tubave lidhës me pompën.
- të montojë pulexhon e pompës.
- të montojë rrypin e pulexhos së pompës.
- të kryejë regjistrimin e shtrëngimit të duhur të rrypit të pulexhos së pompës.
- të mbushë sistemin e ftohjes me sasinë e duhur të lëngut ftohës.
- të kryejë provën e funksionimit të pompës së zëvendësuar.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pompës së ujit të sistemit të ftohjes së motorit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në sistemet e motorëve të automjeteve të lehta.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punimeve kryesore që kryhen në sistemet e motorëve të automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të kryesore në sisteme vajisjes, të ftohjes dhe të ushqimit të motorëve të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të parashikuara në modul
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në sistemet e motorëve të automjeteve.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zëvendësimin në sistemet e motorëve të automjeteve.
 - Automjet mësues me motor në gjendje pune.
 - Pjesë këmbimi të sistemeve të motorëve të automjeteve.
 - Vajra dhe lëngje ftohëse për motorët.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

7. Moduli “Punime kryesore në mekanizin e shpërndarjes së gazeve të motorëve të automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Niveli: I

Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME KRYESORE NE MEKANIZMIN E SHPERNDARJES SE GAZEVE TE MOTOREVE TE AUTOMJETEVE	(M-18-217-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve të motorëve “Otto” dhe “Diesel” të automjeteve të lehta.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zëvendëson rripin e dhëmbëzuar të distribucionit të motorit të automjetit. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e rripit të distribucionit të motorit.- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.- Përzgjedhja e rripit të distribucionit të motorit.- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e rripit të distribucionit motorit.- Zmontimi dhe heqja e mbulesës së motorit.- Zmontimi dhe heqja e kapakut të rripit të distribucionit.- Lirimi i mekanizmit të regjistrimit të tensionimit të rripit të distribucionit motorit.- Heqja e rripit të distribucionit të konsumuar të motorit.- Zmontimi dhe heqja e rrotës së dëmtuar të regjistruarit të tensionimit të rripit.- Vendosja dhe montimi i rrotës së re të regjistruarit të tensionimit të rripit.- Vendosja e rripit të ri distribucionit të motorit.- Regjistrimi i tensionimit të rripit të distribucionit motorit.- Vendosja dhe montimi i kapakut të rripit të distribucionit.- Ndezja e motorit dhe kontrolli i funksionimit të rripit të distribucionit të zëvendësuar.- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë	

zëvendësimin të rripit të distribucionit motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e rripit të distribucionit të motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt rripin e distribucionit të motorit.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e rripit të distribucionit motorit.
- të zmontojë dhe të heqë mbulesën e motorit.
- të zmontojë dhe të heqë kapakun e rripit të distribucionit.
- të lirojë mekanizmin e regjistrimit të tensionimit të rripit të distribucionit motorit.
- të heqë rripin e distribucionit të konsumuar të motorit.
- të zmontojë dhe të heqë rrotën e dëmtuar të regjistruarit të tensionimit të rripit.
- të vendosë dhe të montojë si duhet rrotën e re të regjistruarit të tensionimit të rripit.
- të vendosë si duhet rripin e ri të distribucionit të motorit.
- të regjistrojë tensionimin e duhur të rripit të distribucionit motorit.
- të vendosë dhe të montojë kapakun e rripit të distribucionit
- të ndezë motorin dhe të kontrollojë funksionimin e rripit të distribucionit të zëvendësuar.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të rripit të distribucionit motorit

RM 2 Nxënësi zëvendëson zinxhirin e distribucionit të motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e zinxhirit të distribucionit të motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e zinxhirit të distribucionit të motorit.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e zinxhirit të distribucionit motorit.
- Zmontimi dhe heqja e mbulesës së motorit.
- Zmontimi dhe heqja e kapakut dhe guarnicionit të distribucionit.
- Lirimi dhe heqja e mekanizmit të regjistrimit të tensionimit të zinxhirit të distribucionit motorit.
- Heqja e zinxhirit të konsumuar të distribucionit të motorit.

- Vendosija e zinxhirit të ri distribucionit të motorit.
- Vendosija dhe regjistrimi i mekanizmit të tensionimit të zinxhirit të distribucionit motorit.
- Vendosija e guarnicionit të ri të kapakut të distribucionit.
- Vendosija dhe montimi i kapakut të zinxhirit të distribucionit.
- Ndezja e motorit dhe kontrolli i funksionimit të zinxhirit të distribucionit të zëvendësuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të zinxhirit të distribucionit motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e zinxhirit të distribucionit të motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt zinxhirin e distribucionit të motorit.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e zinxhirit të distribucionit motorit.
- të zmontojë dhe të heqë mbulesën e motorit.
- të zmontojë dhe të heqë kapakun dhe guarnicionin e distribucionit.
- të lirojë dhe të heqë mekanizmin e regjistrimit të tensionimit të zinxhirit të distribucionit motorit.
- të heqë zinxhirin e konsumuar të distribucionit të motorit.
- të vendosë si duhet zinxhirin e ri të distribucionit të motorit.
- të vendosë dhe të regjistrojë si duhet mekanizmin e tensionimit të zinxhirit të distribucionit motorit.
- të vendosë guarnicionin e ri të kapakut të distribucionit.
- të vendosë dhe të montojë kapakun e zinxhirit të distribucionit.
- të ndezë motorin dhe të kontrollojë funksionimin e zinxhirit të distribucionit të zëvendësuar.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të zinxhirit të distribucionit motorit.

RM 3 Nxënësi regjistron hapësirën termikë te valvulat e motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për regjistrimin e valvulave të motorit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për regjistrimin e

- valvulave të motorit.
- Zmontimi dhe heqja e mbulesës së motorit.
- Zmontimi dhe heqja e kapakut dhe guarnicionit të valvulave të motorit.
- Kontrolli me spesimetër i hapësirës termike të secilës prej valvulave të motorit.
- Regjistrimi i hapësirës termike të secilës prej valvulave të motorit.
- Vendosja dhe montimi dhe i guarnicionit dhe kapakut të valvulave të motorit.
- Ndezja e motorit dhe kontrolli i funksionimit të tij pas regjistrimit të hapësirës termike të valvulave të motorit.
- Vendosja dhe montimi i mbulesës së motorit.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë regjistrimit të hapësirës termike të valvulave të motorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për regjistrimin e valvulave të motorit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për regjistrimin e valvulave të motorit.
- të zmontojë dhe të heqë mbulesën e motorit.
- të zmontojë dhe të heqë kapakun dhe guarnicionin e valvulave të motorit.
- të kontrollojë saktë me spesimetër hapësirën termike të secilës prej valvulave të motorit.
- të regjistrojë hapësirën e duhur termike të secilës prej valvulave të motorit.
- të vendosë dhe të montojë guarnicionin dhe kapakun e valvulave të motorit.
- të kryejë ndezjen e motorit dhe kontrollin e funksionimit të tij pas regjistrimit të hapësirës termike të valvulave të motorit.
- të vendosë dhe të montojë mbulesën e motorit.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë regjistrimit të hapësirës termike të valvulave të motorit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve të motorëve të automjeteve të lehta.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e

mundur demonstrimet konkrete të punimeve kryesore që kryhen në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve të motorëve të automjeteve.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për zëvendësimin e rripit të dhëmbëzuar dhe zinxhirit të distribucionit, si dhe për regjistrimin e hapësirës termike të valvulave në motorët e automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të parashikuara në modul
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve të motorëve të automjeteve.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zëvendësimin në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve të motorëve të automjeteve.
 - Automjet mësimor me motor në gjendje pune.
 - Pjesë këmbimi të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorëve të automjeteve.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

8. Moduli “Punime kryesore në sistemin elektrik dhe elektronik të automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Niveli: I

Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME KRYESORE NE SISTEMIN ELEKTRIK DHE ELEKTRONIK TE AUTOMJETEVE	(M-18-1182-15)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme të zëvendësimit të pjesëve në sistemet elektrike dhe elektronike të automjeteve të lehta.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zëvendëson llampat ndriçuese dhe sinjalizuese të automjetit. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit elektrik të automjetit.- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.- Përzgjedhja e llampave për zëvendësim të ndriçuesit dhe sinjalizuesit të automjetit.- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e llampave të ndriçuesve dhe sinjalizuesve të automjetit.- Zmontimi i mbajtëses së llampave të fenerit kryesor.- Procedura e heqjes së llampave së dëmtuara të fenerit kryesor.- Procedura e vendosjes së llampave së reja të fenerit kryesor.- Prova e funksionimit të llampave ndriçuese të zëvendësuara.- Montimi i mbajtëses së llampave të fenerit kryesor.- Zmontimi i kapakëve të sinjalizuesve në pjesën e pasme të automjetit.- Heqja e llampave të dëmtuara të sinjalizuesve të pjesës së pasme të automjetit.- Vendosja e llampave të reja të sinjalizuesve të pjesës së pasme të automjetit.- Prova e funksionimit të llampave sinjalizuese të zëvendësuara.- Montimi i kapakëve të sinjalizuesve në pjesën e pasme të	

-
- automjeti
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
 - Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të llampave ndriçuese dhe sinjalizuese të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt llampat për zëvendësim të ndriçuesit dhe sinjalizuesit të automjetit.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e llampave të ndriçuesve dhe sinjalizuesve të automjetit.
- të zmontojë mbajtësen e llampave të fenerit kryesor.
- të zbatojë procedurat e duhura të heqjes së llampave së dëmtuara të fenerit kryesor.
- të zbatojë procedurat e duhura vendosjes së llampave së reja të fenerit kryesor.
- të kryejë provat e funksionimit të llampave ndriçuese të zëvendësuara.
- të montojë si duhet mbajtësen e llampave të fenerit kryesor.
- të zmontojë kapakët e sinjalizuesve në pjesën e pasme të automjetit.
- të heqë llampat e dëmtuara të sinjalizuesve të pjesës së pasme të automjetit.
- të vendosë si duhet llampa të reja të sinjalizuesit e pjesës së pasme të automjetit.
- të kryejë provat e funksionimit të llampave sinjalizuese të zëvendësuara.
- të montojë si duhet kapakët e sinjalizuesve në pjesën e pasme të automjeti
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të llampave ndriçuese dhe sinjalizuese të automjetit.

RM 2 Nxënësi zëvendëson kandelet dhe fijet e kandeleve të motorit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e kandeleve dhe fijeve të kandeleve të motorit.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e kandeleve dhe fijeve të kandeleve të motorit

- Zmontimi i mbulesës së motorit.
- Zmontimi i fijeve të dëmtuara nga distributori dhe nga kandelet.
- Zmontimi i kandelevë të dëmtuara.
- Montimi i kandelevë të reja.
- Montimi i fijeve të reja me distributorin dhe kandelet.
- Prova e funksionimit të motorit me fijet dhe kandelet e zëvendësuara.
- Montimi i mbulesës së motorit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të fijeve të kandelevë dhe kandelevë në automjet

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt kandelet dhe fijet e kandelevë të motorit.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e kandelevë dhe fijeve të kandelevë të motorit
- të zmontojë mbulesën e motorit.
- të zmontojë fijet e dëmtuara nga distributori dhe nga kandelet.
- të zmontojë kandelet e dëmtuara.
- të montojë si duhet kandelet e reja.
- të montojë sipas rradhës së duhur fijet e reja me distributorin dhe kandelet.
- të kryejë provat e funksionimit të motorit me fijet dhe kandelet e zëvendësuara.
- të montojë mbulesën e motorit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të fijeve të kandelevë dhe kandelevë në automjet

RM 3 Nxënësi zëvendëson kandeletat e motorit me naftë të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e kandeletave të motorit me naftë.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e kandeletave të motorit me naftë.
- Zmontimi i mbulesës së motorit.
- Zmontimi i përcjellësave të kandeletave të motorit me naftë.
- Zmontimi i kandeletave të dëmtuara.
- Montimi i kandeletave të reja.

- Montimi i përcjellësave të kandeletave të motorit me naftë.
- Prova e funksionimit të kandeletave të reja.
- Montimi i mbulesës së motorit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të kandeletave të motorit me naftë, në automjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt kandeletat e motorit me naftë.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e kandeletave të motorit me naftë.
- të zmontojë mbulesën e motorit.
- të zmontojë përcjellësat e kandeletave të motorit me naftë.
- të zmontojë kandeletat e dëmtuara.
- të montojë si duhet kandeletat e reja.
- të montojë përcjellësat e kandeletave të motorit me naftë.
- të kryejë provat e funksionimit të kandeletave të reja.
- të montojë mbulesën e motorit.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të kandeletave të motorit me naftë, në automjet

RM 4 Nxënësi zëvendëson baterinë e sistemit elektrik të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- Analiza e shënimeve teknike të baterisë së sistemit elektrik.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e baterisë së sistemit elektrik.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e baterisë së re të sistemit elektrik të automjetit.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e baterisë së sistemit elektrik.
- Zmontimi i kapikordave të kabllave kryesore nga polet e baterisë që do të zëvendësohet.
- Zmontimi dhe heqja e baterisë që do të zëvendësohet.
- Vendosija dhe montimi i baterisë së re.
- Montimi i kapikordave të kabllave kryesore me polet e baterisë së re.
- Kontrolli i funksionimit të baterisë së re.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të baterisë së sistemit elektrik të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- të analizojë shënimet teknike të baterisë së sistemit elektrik.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zëvendësimin e baterisë së sistemit elektrik.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë baterinë e re të sistemit elektrik të automjetit.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e baterisë së sistemit elektrik.
- të zmontojë kapikordat e kabllave kryesore nga polet e baterisë që do të zëvendësohet.
- të zmontojë dhe të heqë baterinë që do të zëvendësohet.
- të vendosë dhe të montojë si duhet baterinë e re.
- të montojë si duhet kapikordat e kabllave kryesore me polet e baterisë së re.
- të kontrollojë funksionimin e baterisë së re.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të baterisë së sistemit elektrik të automjetit

RM 5 Nxënësi zëvendëson gjeneratorin (dinamon) e sistemit elektrik të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- Analiza e shënimeve teknike të dinamos së sistemit elektrik.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e dinamos së sistemit elektrik.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e dinamos së re të sistemit elektrik.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e dinamos së sistemit elektrik.
- Stakimi i kabllit kryesor të polit negativ të baterisë.
- Lirimi i regjistruerit të shtrëngimit të rripit të gjeneratorit.
- Heqja e rripit të gjeneratorit.
- Shkëputja e lidhjeve të përcjellësave elektrike të gjeneratorit.
- Zmontimi dhe heqja e gjeneratorit të dëmtuar nga trupi i motorit.
- Vendosja dhe montimi i gjeneratorit të ri në trupin e motorit.
- Lidhja e përcjellësave elektrike të gjeneratorit.
- Vendosja e rripit të gjeneratorit.
- Regjistrimi shtrëngimit të rripit të gjeneratorit.
- Takimi i kabllit kryesor të polit negativ të baterisë.
- Kontrolli i funksionimit të gjeneratorit të montuar.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.

- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të gjeneratorit të sistemit elektrik të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- të analizojë shënimet teknike të dinamos së sistemit elektrik.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zëvendësimin e dinamos së sistemit elektrik.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt dinamon e re të sistemit elektrik.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e dinamos së sistemit elektrik.
- të kryejë stakimin e kabllit kryesor të polit negativ të baterisë.
- të lirojë regjistruetin e shtrëngimit të rripit të gjeneratorit.
- të heqë rripin e gjeneratorit.
- të shkëputë lidhjet e përcjellësve elektrike të gjeneratorit.
- të zmontojë dhe të heqë gjeneratorin e dëmtuar nga trupi i motorit.
- të vendosë dhe të montojë si duhet gjeneratorin e ri në trupin e motorit.
- të lidhë si duhet përcjellësat elektrike të gjeneratorit.
- të vendosë rripin e gjeneratorit.
- të kryejë regjistrimin e shtrëngimit të duhur të rripit të gjeneratorit.
- të kryejë takimin e kabllit kryesor të polit negativ të baterisë.
- të kontrollojë funksionimin e gjeneratorit të montuar.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të gjeneratorit të sistemit elektrik të automjetit

RM 6 Nxënësi zëvendëson motorinon e sistemit të lëshimit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- Analiza e shënimeve teknike të motorinos së sistemit të lëshimit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e motorinos së sistemit të lëshimit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e motorinos së re të sistemit të lëshimit.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e motorinos së sistemit të lëshimit.
- Stakimi i kabllit kryesor të polit negativ të baterisë
- Shkëputja e lidhjeve të përcjellësve elektrike të motorinos

- së sistemit të lëshimit.
- Zmontimi dhe heqja e motorinos së dëmtuar të sistemit të lëshimit, nga trupi i motorit.
- Vendosija dhe montimi i motorinos së re të sistemit të lëshimit, në trupin e motorit.
- Lidhja e përcjellësave elektrike të motorinos së sistemit të lëshimit.
- Takimi i kabllit kryesor të polit negativ të baterisë
- Kontrolli i funksionimit të motorinos së re të sistemit të lëshimit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të motorinos së sistemit të lëshimit të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit elektrik të automjetit.
- të analizojë shënimet teknike të motorinos së sistemit të lëshimit.
- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zëvendësimin e motorinos së sistemit të lëshimit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt motorinon e re të sistemit të lëshimit.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e motorinos së sistemit të lëshimit.
- të kryejë stakimin e kabllit kryesor të polit negativ të baterisë
- të shkëputë lidhjet e përcjellësave elektrike të motorinos së sistemit të lëshimit.
- të zmontojë dhe të heqë motorinon e dëmtuar të sistemit të lëshimit, nga trupi i motorit.
- të vendosë dhe të montojë si duhet motorinon e re të sistemit të lëshimit, në trupin e motorit.
- të lidhë si duhet përcjellësat elektrike të motorinos së sistemit të lëshimit.
- të kryejë takimin e kabllit kryesor të polit negativ të baterisë
- të kontrollojë funksionimin e motorinos së re të sistemit të lëshimit.
- të tregojë kujdes për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të motorinos së sistemit të lëshimit të automjetit.

RM 7 Nxënësi zëvendëson pjesë elektronike të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit elektronik të automjetit.

- Analiza e shënimeve teknike të pjesëve (paketa, sensorë, veprues) të sistemit elektronik të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e pjesëve të sistemit elektronik.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e paketës, sensorit apo vepruesit që do të zëvendësohet.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e pjesëve të sistemit elektronik të automjetit.
- Procedura e zëvendësimit të paketave elektronike (proçesorëve).
- Procedura e zëvendësimit të sensorëve.
- Procedura e zëvendësimit të vepruesve (aktuatorëve).
- Kontrolli i funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të sistemit elektronik të automjetit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të sistemit elektronik të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit elektronik të automjetit.
- të analizojë dhe interpretojë shënimet teknike të pjesëve (paketa, sensorë, veprues) të sistemit elektronik të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur së punës për zëvendësimin e pjesëve të sistemit elektronik.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë paketën, sensorin apo vepruesin e duhur për zëvendësim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e pjesëve të sistemit elektronik të automjetit.
- të kryejë procedurat e duhura për zëvendësimin e paketave elektronike (proçesorëve).
- të kryejë procedurat e duhura për zëvendësimin e sensorëve.
- të kryejë procedurat e duhura për zëvendësimin e vepruesve (aktuatorëve).
- të bëjë kontrollin e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të sistemit elektronik të automjetit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të sistemit elektronik të automjetit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të zëvendësimit në sistemin elektrik të automjeteve të lehta.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e

mundur demonstrimet konkrete të punimeve të zëvendësimit të llampave ndriçuese dhe sinjalizuese, kandeleve, fijeve të kandeleve, kandeletave, gjeneratorit, motorinos dhe pjesëve të sistemit elektronik të automjeteve.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të zëvendësimit të llampave ndriçuese dhe sinjalizuese, kandeleve, fijeve të kandeleve, kandeletave, gjeneratorit, motorinos dhe pjesëve të sistemit elektronik të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të parashikuara në modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së punimeve në sistemin elektrik dhe elektronik të automjeteve.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për zëvendësimin e llampave ndriçuese dhe sinjalizuese, kandeleve, fijeve të kandeleve, kandeletave, gjeneratorit, motorinos dhe pjesëve të sistemit elektronik të automjeteve.
 - Automjet mësimor në gjendje pune.
 - Pjesë këmbimi të sistemit elektrik dhe elektronik të automjeteve.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

9. Moduli: “Punime kryesore në transmisionin e automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Niveli: I

Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	PUNIME KRYESORE NE TRANSMISIONIN E AUTOMJETEVE	(M-18-219-09)
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zëvendëson elementet e mekanizmit të fshirësve të xhamave të përparmë të automjeteve. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Analiza e dokumentacionit teknik të mekanizmit të fshirësit të xhamave të përparmë të automjetit.- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e elementeve të mekanizmit të fshirësit të xhamave të përparmë.- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.- Përzgjedhja e elementeve që do të zëvendësohen te mekanizmi i fshirësit të xhamave të përparmë.- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e elementeve të mekanizmit të fshirësit të xhamave të përparmë.- Procedura e zmontimit të mbajtëses së gominës fshirëse të dëmtuar të xhamit të përparmë.- Procedura e montimit të mbajtëses së gominës fshirëse të re të xhamit të përparmë.- Procedura e zmontimit të krahut të dëmtuar të fshirëses së xhamit të përparmë.- Procedura e montimit të krahut të ri të fshirëses së xhamit të përparmë.- Procedura e zmontimit të shufrave (tiranteve) të dëmtuara të fshirëses së xhamit të përparmë.- Procedura e montimit të shufrave (tiranteve) të reja të fshirëses së xhamit të përparmë.- Procedura e shkëputjes së tiranteve dhe lidhjeve elektrike nga blloku motor elektrik-transmission i mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.	

-
- Procedura e zmontimit dhe e heqjes së bllokut motor elektrik-transmision të dëmtuar, të mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.
 - Procedura e vendosjes dhe e montimit të bllokut motor elektrik-transmision të ri.
 - Procedura e rivendosjes së tiranteve dhe lidhjeve elektrike të blloku motor elektrik-transmision i mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.
 - Prova e funksionimit të mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë me elemente të zëvendësuara.
 - Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
 - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
 - Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të elementeve të mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të mekanizmit të fshirësit të xhamave të përparmë të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e elementeve të mekanizmit të fshirësit të xhamave të përparmë.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt elementet që do të zëvendësohen të mekanizmi i fshirësit të xhamave të përparmë.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e elementeve të mekanizmit të fshirësit të xhamave të përparmë.
- të zbatojë procedurat e zmontimit të mbajtëses së gominës fshirëse të dëmtuar të xhamit të përparmë.
- të zbatojë procedurat e montimit të mbajtëses së gominës fshirëse të re të xhamit të përparmë.
- të zbatojë procedurat e zmontimit të krahut të dëmtuar të fshirëses së xhamit të përparmë.
- të zbatojë procedurat e montimit të krahut të ri të fshirëses së xhamit të përparmë.
- të zbatojë procedurat e zmontimit të shufrave (tiranteve) të dëmtuara të fshirëses së xhamit të përparmë.
- të zbatojë procedurat e montimit të shufrave (tiranteve) të reja të fshirëses së xhamit të përparmë.
- të zbatojë procedurat e shkëputjes së tiranteve dhe lidhjeve elektrike nga blloku motor elektrik-transmision i mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.
- të zbatojë procedurat e zmontimit dhe të heqjes së bllokut motor elektrik-transmision të dëmtuar, të mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe e montimit të bllokut motor elektrik-transmision të ri.

- të zbatojë procedurat e rivendosjes së tiranteve dhe lidhjeve elektrike të blloku motor elektrik-transmisioni i mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.
- të kryejë provat e funksionimit të mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë me elemente të zëvendësuara.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të elementeve të mekanizmit të fshirëseve të xhamave të përparmë.

RM 2 Nxënësi zëvendëson bravat e dyerve të automjeteve.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të dyerve të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e bravave të dyerve të automjeteve.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e bravave të dyerve për zëvendësim.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e bravave të dyerve.
- Zmontimi i dorezës së brendëshme për tërheqjen e derës.
- Zmontimi i kornizës së dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
- Zmontimi i dorezës për komandimin manual të xhamit të derës.
- Zmontimi dhe heqja e panelit të brendshëm të derës.
- Zmontimi i tiranteve të ndryshëm që lidhen me bravën e derës.
- Çvidhosja e vidave që mbërthejnë bravën dhe heqja e bravës së dëmtuar të derës.
- Vendosja dhe mbërthimi me vida i bravës së re të derës.
- Montimi i tiranteve të ndryshëm që lidhen me bravën e derës.
- Vendosja dhe montimi i panelit të brendshëm të derës.
- Montimi i dorezës për komandimin manual të xhamit të derës.
- Montimi i kornizës së dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
- Montimi i dorezës së brendëshme për tërheqjen e derës.
- Prova e funksionimit të bravës së re të derës.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të bravave të dyerve në automjete.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të dyerve të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e

- bravave të dyerve të automjeteve.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
 - të përzgjedhë drejt bravat e dyerve për zëvendësim.
 - të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e bravave të dyerve.
 - të zmontojë dorezën e brendëshme për tërheqjen e derës.
 - të zmontojë kornizën e dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
 - të zmontojë dorezën për komandimin manual të xhamit të derës.
 - të zmontojë dhe të heqë panelin e brendshëm të derës.
 - të zmontojë tirantet e ndryshme që lidhen me bravën e derës.
 - të çvidhosë vidat që mbërthejnë bravën dhe të heqë bravën e dëmtuar të derës.
 - të vendosë dhe të mbërthejë me vida bravën e re të derës.
 - të montojë tirantet e ndryshme që lidhen me bravën e derës.
 - të vendosë dhe të montojë panelin e brendshëm të derës.
 - të montojë dorezën për komandimin manual të xhamit të derës.
 - të montojë kornizën e dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
 - të montojë dorezën e brendëshme për tërheqjen e derës.
 - të kryejë provat e funksionimit të bravës së re të derës.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të bravave të dyerve në automjete

RM 3 Nxënësi zëvendëson mekanizmin manual të komandimit të xhamave të dyerve të automjeteve.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të dyerve të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e mekanizmit manual të komandimit të xhamave të dyerve të automjeteve.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e mekanizmit manual të komandimit të xhamit të derës për zëvendësim.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e mekanizmit manual të komandimit të xhamit të derës.
- Zmontimi i dorezës së brendëshme për tërheqjen e derës.
- Zmontimi i kornizës së dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
- Zmontimi i dorezës për komandimin manual të xhamit të derës.
- Zmontimi dhe heqja e panelit të brendshëm të derës.
- Ulja e xhamit në pozicion të përshtatshëm për zmontim.
- Lirimi i vidave mbërtheuese të mbajtëses së xhamit me rrëshqitësin e mekanizmit.
- Zmontimi i mbajtëseve të mekanizmit të komandimit manual të xhamit të derës.

- Heqja e mekanizmit të dëmtuar të komandimit manual të xhamit të derës.
- Vendosja dhe montimi i mbajtëseve të mekanizmit të ri të komandimit manual të xhamit të derës.
- Montimi me vida i mbajtëses së xhamit me rrëshqitësin e mekanizmit.
- Prova e komandimit manual të uljes dhe ngritjes së xhamit të derës.
- Vendosja dhe montimi i panelit të brendshëm të derës.
- Montimi i dorezës për komandimin manual të xhamit të derës.
- Montimi i kornizës së dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
- Montimi i dorezës së brendëshme për tërheqjen e derës.
- Prova përfundimtare e funksionimit të mekanizmit të ri të komandimit manual të xhamit të derës.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të mekanizmit të komandimit manual të xhamit të derës në automjete.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të dymve të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e mekanizmit manual të komandimit të xhamave të dymve.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt mekanizmin manual të komandimit të xhamit të derës për zëvendësim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e mekanizmit manual të komandimit të xhamit të derës.
- të zmontojë dorezën e brendëshme për tërheqjen e derës.
- të zmontojë kornizën e dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
- të zmontojë dorezën për komandimin manual të xhamit.
- të zmontojë dhe të heqë panelin e brendshëm të derës.
- të ulë xhamin në pozicion e përshtatshëm për zmontim.
- të lirojë vidat mbërthyes të mbajtëses së xhamit me rrëshqitësin e mekanizmit.
- të zmontojë mbajtësen e mekanizmit të komandimit manual të xhamit të derës.
- të heqë mekanizmin e dëmtuar të komandimit manual të xhamit të derës.
- të vendosë dhe të montojë mbajtësen e mekanizmit të ri të komandimit manual të xhamit të derës.
- të montojë me vida mbajtësen e xhamit me rrëshqitësin e mekanizmit.
- të kryejë provat e komandimit manual të uljes dhe ngritjes së

xhamit të derës.

- të vendosë dhe të montojë panelin e brendshëm të derës.
- të montojë dorezën për komandimin manual të xhamit të derës.
- të montojë kornizën e dorezës së brendëshme për hapjen e derës.
- të montojë dorezën e brendëshme për tërheqjen e derës.
- të kryejë provat përfundimtare të funksionimit të mekanizmit të ri të komandimit manual të xhamit të derës.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të mekanizmit të komandimit manual të

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në mekanizmin e fshirjes së xhamave, në bravat e dyerve dhe në mekanizmat manuale të komandimit të xhamave të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së mirëmbajtjes dhe zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zëvendësimin në sistemet ndihmëse të automjeteve.
 - Automjet mësuesor.
 - Detale dhe nyje të mekanizmit të fshirjes së xhamave, bravave të dyerve dhe të mekanizmit manual të komandimit të xhamave të automjeteve.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli: “Punime në sistemin e ajrit të kondicionuar të automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjetesh transporti

Niveli: I

Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodit	PUNIME NE SISTEMIN E AJRIT TE KONDICIONUAR TE AUTOMJETEVE	(M-18-1184-15)
-------------------	---	----------------

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme të zëvendësimit të pjesëve të sistemit të ajrit të kondicionuar të automjeteve të lehta.

Kohëzgjatja e modulit 68 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, niveli I.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi zëvendëson filtrin e ajrit të kondicionuar.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit të ajrit të kondicionuar të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e filtrit të ajrit të kondicionuar.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e filtrit për të bërë zëvendësimin
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e filtrit të ajrit të kondicionuar.
- Lirimi i vidave të kapakut të folesë së filtrit të ajrit të kondicionuar.
- Heqja e kapakut të folesë së filtrit të ajrit të kondicionuar.
- Heqja e filtrit të papastër të ajrit të kondicionuar.
- Vendosja në fole e filtrit të ri të ajrit të kondicionuar.
- Vendosja dhe montimi i kapakut të folesë së filtrit të ajrit të kondicionuar.
- Prova e funksionimit të sistemit të ajrit të kondicionuar me filtër të zëvendësuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit filtrit të ajrit të kondicionuar të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të sistemit të

-
- ajrit të kondicionuar të automjetit.
 - të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e filtrit të ajrit të kondicionuar të automjetit.
 - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
 - të përzgjedhë filtrin e duhur për të bërë zëvendësimin
 - të përgatitë automjetin dhe vendit të punës për të bërë zëvendësimin e filtrit të ajrit të kondicionuar.
 - të bëjë lirimimin e vidave dhe të heqë kapakun e folesë së filtrit të ajrit të kondicionuar.
 - të heqë filtrin e papastër të ajrit të kondicionuar.
 - të vendosë siç duhet në fole, filtrin e ajrit të kondicionuar.
 - të vendosë dhe të montojë kapakun e folesë së filtrit të ajrit të kondicionuar.
 - të bëjë provën e funksionimit të sistemit të ajrit të kondicionuar me filtër të zëvendësuar.
 - të kryejë pastrimet e nevojshme.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të filtrave të ajrit të kondicionuar të automjeteve të lehta.

RM 2 Nxënësi zëvendëson rripin e kompresorit të ajrit të kondicionuar.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit të ajrit të kondicionuar (A/C) të automjetit
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e rripit të kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e rripit për zëvendësim
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e rripit të kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- Heqja e pjesëve që pengojnë zëvendësimin e rripit të kompresorit.
- Lirimi i vidave të pajisjes regjistruese të rripit të kompresorit
- Lirimi dhe heqja e rripit të konsumuar të kompresorit.
- Vendosja e rripit të ri të kompresorit
- Shtërngimi dhe regjistrimi i rripit të ri të kompresorit.
- Vendosja e pjesëve të hequra.
- Prova e funksionimit të rripit të zëvendësuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të rripit të kompresorit të sistemit të A/C të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të sistemit të ajrit të

- kondicionuar (A/C) të automjetit
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e rripit të kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës.
- të përzgjedhë rripin e duhur për zëvendësim
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e rripit të kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- të bëjë heqjen e pjesëve që pengojnë zëvendësimin e rripit të kompresorit
- të bëjë lirim të vidave të pajisjes regjistruese të rripit të kompresorit
- të bëjë lirim dhe heqjen e rripit të konsumuar të kompresorit.
- të vendosë rripin e ri të kompresorit
- të bëjë shtrëngimin dhe regjistrimin e rripit të ri të kompresorit.
- të bëjë provën e funksionimit të rripit të zëvendësuar.
- të vendosë pjesët e hequra.
- të bëjë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të rripit të kompresorit të sistemit të A/C të automjeteve të lehta.

RM 3 Nxënësi zëvendëson kompresorin e ajrit të kondicionuar.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit të ajrit të kondicionuar (A/C) të automjetit
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e kompresorit për zëvendësim
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- Heqja e gazit nga sistemi.
- Heqja e pjesëve që pengojnë zëvendësimin e kompresorit.
- Shkëputja e lidhjeve elektrike nga kompresori
- Heqja e rripit të kompresorit.
- Shkëputja e tubave të gazit nga kompresori
- Lirimi i vidave/bulonave që mbajnë kompresorin.
- Heqja e kompresorit të dëmtuar.
- Vendosja e kompresorit të ri dhe shtrëngimi i vidave/bulonave mbajtës.
- Lidhja e tubave të gazit me kompresorin.
- Montimi dhe regjistrimi i rripit të kompresorit.
- Rivendosja e lidhjeve elektrike në kompresor
- Vendosja e pjesëve të hequra.
- Mbushja me gaz të sistemit të A/C
- Prova e funksionimit të kompresorit të zëvendësuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.

- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të kompresorit të sistemit të A/C të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të sistemit të ajrit të kondicionuar (A/C) të automjetit
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës.
- të përzgjedhë kompresorin e duhur për zëvendësim
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e kompresorit të sistemit të A/C të automjetit.
- të bëjë heqjen e gazit nga sistemi
- të bëjë heqjen e pjesëve që pengojnë zëvendësimin e kompresorit
- të shkëputë lidhjet elektrike nga kompresori
- të bëjë heqjen e rripit të kompresorit.
- të shkëputë tubat e gazit nga kompresori
- të bëjë lirim të vidave/bulonave që mbajnë kompresorin.
- Të bëjë heqjen e kompresorit të dëmtuar.
- Të bëjë vendosjen e kompresorit të ri dhe shtrëngimin e vidave/bulonave mbajtës.
- të bëjë lidhjen e tubave të gazit në kompresor
- të bëjë montimin dhe regjistrimin e rripit të kompresorit.
- të rivendosë lidhjet elektrike në kompresor
- të vendosë pjesët e hequra.
- të mbushë me gaz sistemin
- të bëjë provën e funksionimit të kompresorit të zëvendësuar.
- të bëjë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të kompresorit të sistemit të A/C të automjeteve të lehta.

RM 4 Nxënësi zëvendëson avulluesin dhe kondensuesin e sistemit të ajrit të kondicionuar.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit të ajrit të kondicionuar (A/C) të automjetit
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e avulluesit dhe kondensuesit të sistemit të A/C të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e avulluesit dhe kondensuesit për zëvendësim
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e avulluesit dhe kondensuesit të sistemit të A/C të automjetit.

- Heqja e gazit nga sistemi
- Heqja e pjesëve që pengojnë zëvendësimin e avulluesit dhe të kondensuesit.
- Shkëputja e lidhjeve elektrike nga avulluesi dhe kondensuesi nëse ka të tilla)
- Shkëputja e tubave të hyrjes dhe të daljes së gazit nga avulluesi dhe kondensuesi
- Lirimi i mbajtëseve të avulluesit dhe kondensuesit.
- Heqja e avulluesit dhe kondensuesit të dëmtuar.
- Vendosija dhe shtrëngimi i avulluesit dhe kondensuesit të ri.
- Rilidhja e tubave të hyrjes dhe daljes së gazit në avullues dhe kondensues.
- Rivendosija e lidhjeve elektrike të avulluesit dhe kondensuesit
- Vendosija e pjesëve të hequra.
- Mbushja me gaz e sistemit të A/C
- Prova e funksionimit të avulluesit dhe kondensuesit të zëvendësuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të avulluesit dhe kondensuesit të sistemit të A/C të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të sistemit të ajrit të kondicionuar (A/C) të automjetit
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e avulluesit dhe kondensuesit të sistemit të A/C të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e punës.
- të përzgjedhë avulluesin dhe kondensuesin e duhur për zëvendësim
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e avulluesit dhe kondensuesit të sistemit të A/C të automjetit.
- të bëjë heqjen e gazit nga sistemi
- të heqë pjesët që pengojnë zëvendësimin e avulluesit dhe kondensuesit.
- të shkëputë lidhjet elektrike nga avulluesi dhe kondensuesi
- të shkëputë tubat e hyrjes dhe të daljes së gazit nga avulluesi dhe kondensuesi
- të bëjë lirimin e mbajtëseve të avulluesit dhe kondensuesit.
- të bëjë heqjen e avulluesit dhe kondensuesit të dëmtuar.
- të bëjë vendosjen dhe shtrëngimin e avulluesit dhe kondensuesit të ri.
- të bëjë rilidhjen e tubave të hyrjes dhe daljes së gazit në avullues dhe kondensues.
- të bëjë rivendosijen e lidhjeve elektrike të avulluesit dhe kondensuesit

- të vendosë pjesët e hequra.
- të mbushë me gaz sistemin
- të bëjë provën e funksionimit të avulluesit dhe kondensuesit të zëvendësuar.
- të bëjë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të avulluesit dhe kondensuesit të sistemit të A/C të automjeteve të lehta.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të zëvendësimit të pjesëve në sistemin e ajrit të kondicionuar të automjeteve të lehta.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të zëvendësimit të pjesëve të sistemit A/C të automjeteve të lehta.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të zëvendësimit të filtrit, kompresorit dhe rripit të tij, avulluesit dhe kondensuesit të sistemit të A/C të automjeteve të lehta, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës së zëvendësimit të pjesëve në sistemin e A/C të automjeteve të lehta.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset të praktikës së zëvendësimit në sistemin e A/C të automjeteve të lehta.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për zëvendësimin e pjesëve në sistemin e A/C të automjeteve të lehta.
 - Automjet mësues.
 - Pjesë të ndryshme (filtra, rripa, kompresorë, avullues, kondensues) të sistemit të A/C të automjeteve të lehta.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli: “Punime zëvendësimi në karrocërinë e automjeteve”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti

Niveli: I

Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME ZEVENDËSIMI NE KARROCERINE E AUTOMJETEVE	(M-18-226-09)
------------------	--	----------------------

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme të zëvendësimit të pjesëve kryesore në karrocërinë e automjeteve të lehta.

Kohëzgjatja e modulit 68 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Shërbime mjeteve transporti”, niveli I.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi zëvendëson dyert anësore të automjeteve të lehta.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të dyerve anësore të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e dyerve anësore të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e derës anësore të automjetit për zëvendësim.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e derës anësore.
- Shkëputja e lidhjeve elektrike, mekanike ose pneumatike të derës së dëmtuar me automjetin.
- Lirimi i bulonave të menteshave të derës që do të zëvendësohet.
- Zmontimi i kapjeve të tjera të derës me kornizën e derës.
- Heqja e derës së dëmtuar.
- Pozicionimi dhe montimi të menteshat e derës së re.
- Montimi i kapjeve të tjera të derës së re me kornizën e derës.
- Regjistrimi i pozicionit të përshtatshëm të derës së re.
- Rivendosja e lidhjeve elektrike, mekanike ose pneumatike të derës së re me automjetin.
- Prova e funksionimit të derës së re të montuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të dyerve anësore të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të dyerve anësore të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e dyerve anësore të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt derën anësore të automjetit për zëvendësim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e derës anësore.
- të shkëputë lidhjet elektrike, mekanike ose pneumatike të derës së dëmtuar me automjetin.
- të lirojë bulonat e menteshave të derës që do të zëvendësohet.
- të zmontojë kapje të tjera të derës me kornizën e derës.
- të heqë derën e dëmtuar.
- të pozicionojë dhe të montojë menteshat e derës së re.
- të montojë kapjet e tjera të derës së re me kornizën e derës.
- të kryejë regjistrimin e pozicionit të përshtatshëm të derës së re.
- të rivendosë lidhjet elektrike, mekanike ose pneumatike të derës së re me automjetin.
- të kryejë provat e funksionimit të derës së re të montuar.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të dyerve anësore të automjeteve të lehta.

RM 2 Nxënësi zëvendëson derën e bagazhit të automjeteve të lehta.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të derës së bagazhit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e derës së bagazhit të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e derës së bagazhit të automjetit për zëvendësim
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e derës së bagazhit të automjetit.
- Shkëputja e lidhjeve elektrike, mekanike ose pneumatike të derës së bagazhit të dëmtuar me automjetin.
- Lirimi i bulonave të menteshave të derës së bagazhit që do të zëvendësohet.
- Zmontimi i kapjeve të tjera të derës së bagazhit, me kornizën e derës.
- Heqja e derës së dëmtuar të bagazhit.
- Pozicionimi dhe montimi te menteshat e derës së re të bagazhit.
- Montimi i kapjeve të tjera të derës së re të bagazhit, me

- kornizën e derës.
- Regjistrimi i pozicionit të përshtatshëm të derës së re të bagazhit.
 - Rivendosja e lidhjeve elektrike, mekanike, hidraulike ose pneumatike të derës së re të bagazhit, me automjetin.
 - Prova e funksionimit të derës së re të bagazhit të montuar.
 - Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
 - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
 - Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të derës së bagazhit të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të derës së bagazhit të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e derës së bagazhit të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt derën e bagazhit të automjetit për zëvendësim
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e derës së bagazhit të automjetit.
- të shkëputë lidhjet elektrike, mekanike ose pneumatike të derës së bagazhit të dëmtuar me automjetin.
- të lirojë bulonat e menteshave të derës së bagazhit që do të zëvendësohet.
- të zmontojë kapjet e tjera të derës së bagazhit, me kornizën e derës.
- të heqë derën e dëmtuar të bagazhit.
- të pozicionojë dhe të montojë menteshat e derës së re të bagazhit.
- të montojë kapjet e tjera të derës së re të bagazhit, me kornizën e derës.
- të kryejë regjistrimin e pozicionit të përshtatshëm të derës së re të bagazhit.
- të rivendosë lidhjet elektrike, mekanike, hidraulike ose pneumatike të derës së re të bagazhit, me automjetin.
- të kryejë provat e funksionimit të derës së re të bagazhit të montuar.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të derës së bagazhit të automjeteve të lehta.

RM 3 Nxënësi zëvendëson kofanon e motorit të automjeteve të lehta.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të kofanos së motorit të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e kofanos së motorit të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e kofanos së motorit të automjetit për zëvendësim
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e kofanos së motorit.
- Shkëputja e lidhjeve elektrike ose mekanike (nëse ka) të kofanos së dëmtuar me automjetin.
- Lirimi i bulonave të menteshave të kofanos së motorit, që do të zëvendësohet.
- Heqja e kofanos së dëmtuar të motorit.
- Pozicionimi dhe montimi te menteshat e kofanos së re të motorit.
- Regjistrimi i pozicionit të përshtatshëm të kofanos së re të motorit.
- Rivendosja e lidhjeve elektrike ose mekanike të kofanos së re, me automjetin.
- Prova e funksionimit të kofanos së re të montuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të kofanos së motorit të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të kofanos së motorit të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e kofanos së motorit të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt kofanon e motorit të automjetit për zëvendësim
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e kofanos së motorit.
- të shkëputë lidhjet elektrike ose mekanike (nëse ka) të kofanos së dëmtuar me automjetin.
- të lirojë bulonat e menteshave të kofanos së motorit, që do të zëvendësohet.
- të heqë kofanon e dëmtuar të motorit.
- të pozicionojë dhe të montojë menteshat e kofanos së re të motorit.
- të kryejë regjistrimin e pozicionit të përshtatshëm të kofanos së re të motorit.
- të rivendosë lidhjet elektrike ose mekanike të kofanos së re, me automjetin.

- të kryejë provat e funksionimit të kofanos së re të montuar.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të kofanos së motorit të automjeteve të lehta.

RM 4 Nxënësi zëvendëson parakolpin dhe maskarionon e automjeteve të lehta.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të pjesës së përparme të automjetit.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e parakolpit dhe maskarionos së automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e parakolpit dhe maskarionos së automjetit për zëvendësim
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e parakolpit dhe maskarionos së automjetit.
- Lirimi i vidave dhe bolonave që fiksojnë maskarionon e dëmtuar në pjesën e përparme të automjetit.
- Heqja e maskarionos së dëmtuar të automjetit.
- Lirimi i bulonave që fiksojnë parakolpin me shasinë e automjetit.
- Heqja e parakolpit të dëmtuar të automjetit.
- Pozicionimi i parakolpit të ri në shasinë e automjetit.
- Montimi me bulona i parakolpit të ri të automjetit.
- Pozicionimi i maskarionos së re në pjesën e përparme të automjetit.
- Shtërngimi i vidave dhe bolonave që fiksojnë maskarionon e re në pjesën e përparme të automjetit.
- Kontrolli i fiksimit të parakolpit të ri dhe maskarionos së re të montuara.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të parakolpit dhe maskarionos së automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të pjesës së përparme të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e parakolpit dhe maskarionos së automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt parakolpin dhe maskarionon e automjetit për zëvendësim
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin

- e parakolpit dhe maskarinos së automjetit.
- të lirojë vidat dhe bolonat që fiksojnë maskarinon e dëmtuar në pjesën e përparme të automjetit.
- të heqë maskarinon e dëmtuar të automjetit.
- të lirojë bulonat që fiksojnë parakolpin me shasinë e automjetit.
- të heqë parakolpin e dëmtuar të automjetit.
- të pozicionojë parakolpin e ri në shasinë e automjetit.
- të montojë me bulona parakolpin e ri të automjetit.
- të pozicionojë maskarinon e re në pjesën e përparme të automjetit.
- të shtrëngojë vidat dhe bolonat që fiksojnë maskarinon e re në pjesën e përparme të automjetit.
- të kontrollojë fiksimin e parakolpit të ri dhe maskarinos së re të montuara.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të parakolpit dhe maskarinos së automjeteve të lehta.

RM 5 Nxënësi zëvendëson parafangot e përparme të automjeteve të lehta.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të pjesës së përparme të automjetit të lehtë.
- Përcaktimi i rradhës së punës për zëvendësimin e parafangos së përparme të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës.
- Përzgjedhja e parafangos së përparme të automjetit për zëvendësim.
- Përgatitja e automjetit dhe vendit të punës për zëvendësimin e parafangos së përparme të automjetit.
- Zmontimi dhe heqja e rrotës në krahun e parafangos që do të zëvendësohet (nëse është e nevojshme).
- Zmontimi dhe heqja e elementeve që mund të jenë montuar në parafangon e përparme (psh, antenën e radios).
- Lirimi i vidave dhe bolonave që fiksojnë parafangon e përparme me shasinë dhe pjesët e tjera të karrocërisë së automjetit.
- Heqja e parafangos së përparme të dëmtuar të automjetit.
- Pozicionimi i parafangos së përparme të re në vendin ku do të montohet.
- Vendosija dhe shtrëngimi i vidave dhe bolonave që fiksojnë parafangon e përparme të re me shasinë dhe pjesët e tjera të karrocërisë së automjetit.
- Kontrolli i fiksimit të parafangos së përparme të re, të montuar.
- Kryerja e pastrimeve të nevojshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.

- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të parafangove të përparme të automjeteve të lehta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të pjesës së përparme të automjetit të lehtë.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e parafangos së përparme të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt parafangon e përparme të automjetit për zëvendësim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e parafangos së përparme të automjetit.
- të zmontojë dhe të heqë rrotën në krahun e parafangos që do të zëvendësohet (nëse është e nevojshme).
- të zmontojë dhe të heqë elementet që mund të jenë montuar në parafangon e përparme (psh, antenën e radios).
- të lirojë vidat dhe bolonat që fiksojnë parafangon e përparme me shasinë dhe pjesët e tjera të karrocërisë së automjetit.
- të heqë parafangon e përparme të dëmtuar të automjetit.
- të pozicionojë parafangon e përparme të re në vendin ku do të montohet.
- të vendosë dhe të shtrëngojë vidat dhe bolonat që fiksojnë parafangon e përparme të re me shasinë dhe pjesët e tjera të karrocërisë së automjetit.
- të kontrollojë fiksimin e parafangos së përparme të re, të montuar.
- të kryejë pastrimet e nevojshme.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të parafangove të përparme të automjeteve të lehta.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të zëvendësimit të pjesëve në karrocërinë e automjeteve të lehta.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të zëvendësimit të pjesëve në karrocërinë e automjeteve të lehta.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të zëvendësimit të dyerve, derës së bagazhit, kofanos së motorit, parafangove të përparme, parakolpeve dhe maskarinove në karrocërinë e automjeteve të lehta, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës së zëvendësimit të pjesëve në karrocerinë e automjeteve të lehta.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së zëvendësimit në karrocerinë e automjeteve të lehta.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për zëvendësimin e pjesëve në karrocerinë e automjeteve të lehta.
 - Automjet mësues.
 - Pjesë të ndryshme të karrocërisë së automjeteve të lehta.
 - Katalloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-